

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti për
Shqipërinë
2019



matrica e
monitorimit



Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Raporti Për Shqipërinë 2019

Qershor 2020

Publikoi: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Grupi i Vëzhgimit

Arbana Dibra
Enela Mone
Kristina Lato
Xhoana Zeqo

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Ana Zenelaj
Arbana Dibra
Enela Mone
Xhoana Zeqo

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha
Klotilda Kosta
Kostandina Këruti

Grafika dhe faqosja:

Elona Kapexhiu

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Adresa: Macedonia Street 43-1/9, 1000 Skopje, Republic of North Macedonia

Telefon: +389 2 6144 211

Email: executiveoffice@balkancsd.net

Website: www.balkancsd.net

www.monitoringmatrix.net

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: info@resourcecentre.al

Website: www.resourcecentre.al

Adresa: Rruga e Elbasanit, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73, Tirana

Telefon: 00355 4 2254 881

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Tiranë, Shqipëri 2020

Një version elektronik është i disponueshëm tek faja e internetit e Partnerëve Shqipëri: www.partnersalbania.org, tek Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile: www.resourcecentre.al, tek rrjeti BCSDN: www.balkancsd.net dhe tek: <http://www.monitoringmatrix.net>

Ky raport është pjesë e projektit "Protecting Civic Space - Regional Civil Society Development Hub", financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe zbatuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, në bashkëpunim me anëtarët e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi; dhe pjesë e aktiviteteve të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe pozicionin zyrtar dhe opinionin e SIDA.

Tabela e përmbajtjes

Akronime	6
Hyrje	7
Gjetjet Kryesore.....	13
Rekomandimet Kryesore.....	14
Gjetjet	15
Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit.....	15
Nën-fusha 1.2. Liri të Tjera.....	20
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OShC-të.....	23
Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor / fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre	23
Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit.....	28
Nën-fusha 2.3. Burimet Njerëzore	33
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet-OSHC.....	37
Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim.....	37
Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.....	41
Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve.....	47
Shtojcat	53
Modelimi dhe mbledhja e të dhënave	53
Analiza dhe interpretimi i të dhënave	54
2. Shënime mbi metodologjinë dhe sfidat shtetërore.....	55
3. Burime të përdorura/Bibliografia.....	58

Akronime

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BCSDN	Rrjeti Ballkanik Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
BE	Bashkimi Evropian
DBESH	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
VF	Vit Fiskal
MM	Matrica e Monitorimit
AP	Anëtarët e Parlamentit
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
QKBSHC	Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

HYRJE

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri dhe Rrjeti Ballkanik Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile kanë kënaqësinë të paraqesin edicionin e shtatë të Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, duke mbuluar zhvillimet kryesore në Shqipëri, gjatë vitit 2019.

Ky raport është pjesë e një seri raportesh vendore që mbulojnë shtatë vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali e Zi, Serbia dhe Turqia.

Gjithashtu, një raport rajonal që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet kryesore për të gjitha vendet dhe një platformë interneti që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve janë të disponueshme tek www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit, e zhvilluar në 2013 nga BCSDN me mbështetjen e aëtarëve të saj, partnerëve, Qendrës Ndërkombëtare për Ligjin Jo-fitimprurës (ICNL) dhe Qendrës Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës (ICNL/ECNL), prezanton parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe mundësues për veprimtarinë e OSHC-ve.

Matrica është e organizuar në tre fusha, secila e ndarë sipas nën-fushave¹:

1. Garancitë themelore juridike të lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

Parimet, standardet dhe indikatorët mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe në praktikën rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të zhvillohet dhe funksionojë në mënyrë efektive. Matrica synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist, i cili mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimit praktik të tij².

Përveç monitorimit të thelluar dhe cilësor, në vitin 2015 u prezantua një vlerësim i mjedisit mundësues me një kategorizim që varion nga një mjedis aspak mundësues deri në mjedisin plotësisht mundësues. Ky vlerësim u krijua me qëllim adresimin e nevojës të një komunikimi "të kompresuar" dhe efektiv të gjetjeve, si dhe për prezantimin sistematik të ndryshimeve të standarteve në mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve në nivelin e standardeve në të gjithë vendet dhe për të gjitha vitet. Ky vlerësim nuk zëvendëson, por plotëson vlerësimin cilësor, pasi raportet narrative kombëtare janë baza mbi të cilën kryhet kategorizimi.

Hulumtimi i kryer nëpërmjet MM synon të sigurojë raportime hije mbi mjedisin mundësues për OSHC-të dhe të ndikojë në politikën e zgjerimit dhe në mbështetjen financiare drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe strategjik të sektorit.

¹ Si një mjet hulumtimi për matjen e mjedisit mundësues ligjor, rregullator dhe financiar në të cilin veprojnë OSHC-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, matrica synon t'i përgjigjet nevojës së OShC-ve për të pasur produkte kërkimore të bazuara në dhëna konkrete dhe kapacitete për të advokuar drejt një mjedisi më mundësues për shoqërinë civile.

² . Për këto qëllime, brenda gjetjeve, raporti bën referenca dhe korrelacione të mëtejshme me Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në vendet e Zgjerimit 2014-2020.

Mirënjohje

Raporti i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile - Raporti për Shqipërinë 2019 është përgatitur nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në bashkëpunim dhe me mbështetjen e OShC-ve.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre drejtorëve ekzekutivë dhe menaxherëve të nivelit të lartë të OShC-ve për të cilët morën pjesë në këtë studim me një kampion prej 152 OSHC-ve, duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e dedikuar si dhe falenderon për bashkëpunimin dhe korrektësinë institucionet publike që iu përgjigjën kërkesës për informacionin e kërkuar.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore Për Shoqërinë Civile në Shqipëri dëshirojnë të falenderojnë Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Rrjetin Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) për mbështetjen e tyre në zhvillimin, orientimin dhe zbatimin e kësaj përpjekjeje monitoruese.

Vështrim i Përgjithshëm i Vëndit

Zhvillimi i sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri është ndikuar nga etapat e zhvillimeve përmes së cilave ka kaluar vendi, dhe është shoqëruar me nisma dhe ndryshime ligjore që kanë ndikuar në mjedisin mundësues për funksionimin dhe veprimtarinë e OSHC-ve. Gjatë këtyre tre dekadave, madhësia e sektorit të shoqërisë civile është rritur jo vetëm në shifra, por dhe në ndikimin e saj në shoqëri, reflektuar kjo me ndryshime ligjore dhe aktivizmin e organizatave të shoqërisë civile në vend.

Gjatë vitit 2019, mjedisi politik në vend ka qenë i tensionuar. Në shkurt, deputetët e opozitës hoqën dorë nga mandatet e tyre pasi nisma e propozuar prej tyre për vetëgënjim të politikanëve nuk u votua nga Parlamenti. Si rrjedhojë ata njoftuan bojkotim të Zgjedhjeve Vendore të 30 Qershor 2019 deri në dorëheqjen e Kryeministrit dhe formimin e një qeverie teknike. Por jo të gjithë anëtarët e partive opozitare e përkrahën këtë vendim politik dhe deputetët e rinj opozitar u certifikuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe aktualisht po përfaqësojnë partitë opozitare në Parlament.

Kriza politike u intensifikua edhe më shumë nga përplasjet midis Parlamentit dhe Presidentit. Presidenti revokoi dekretin e tij mbi organizimin e Zgjedhjeve Vendore në 30 Qershor 2019, ndërsa Parlamenti miratoi një rezolutë që e shpalli të pavlefshëm revokimin.³ Zgjedhjet Lokale u mbajtën më 30 qershor, me mungesën e partive opozitare, dhe me votues që kishin shumë pak alternativa politike domethënëse për të zgjedhur.⁴

Pavarësisht rekomandimit pozitiv e të pakushtëzuar nga Komisioni Evropian për të çelur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, në tetor 2019 Këshilli Evropian vendosi të shtyjë atë.⁵ Nga ana tjetër, 86% e qytetarëve shqiptarë janë në favor të anëtarësimit në BE të vendit.⁶ Për të hyrë në Bashkimin Evropian, vitet e fundit janë duke u zbatuar një seri reformash ekonomike. Sidoqoftë, më shumë duhet bërë për lehtësinë e të bërit biznes, pasi sipas raportit "Të Bërit Biznes" vendi humbi 19 pozicione në krahasim me një vit më parë.⁷

Më 26 Nëntor një tërmet goditi Shqipërinë. Ishte një nga tërmetet më të fuqishme që ka goditur vendin tonë. Si pasojë, 51 vetë humbën jetën dhe mijëra të tjerë u kthyen të pastrehë. Kjo katastrofë natyrore zbuloi një sens masiv solidariteti dhe nxori në pah aspektin e vullnetarizmit karakteristik të shqiptarëve.⁸ OSHC-të u angazhuan në mënyrë aktive në përpjekjet për ndihmë, duke siguruar jo vetëm ofrimin e mallrave në një mënyrë të koordinuar, por gjithashtu duke ofruar shërbime të mbështetjes psikologjike si dhe duke organizuar aktivitete rekreative për fëmijë, gra dhe të moshuar në qendra të ndryshme akomodimi.

3 "Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Lokale 30 Qershor 2019 Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve ODIHR", OSBE - OHDIR 2019 [Online] <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/429230?download=true>

4 "Zgjedhjet Lokale 2019 Deklarata e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, OSBE - OHDIR, Qershor 2009 [Online] <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/424433?download=true>


5 Hapja e negociatave të antarsimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, Rezoluta e Parlamentit Evropian [Online]. https://eeas.europa.eu/delegations/albania/69440/resolution-european-parliament_en

6 "Barometri i Ballkanit 2019: Matja e Opinioneve Publike, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, 2019 [Online]. <https://www.rcc.int/pubs/89/balkan-barometer-2019-public-opinion-survey>

7 "Doing Business, Measuring Business Regulation 2020", Banka Botërore, 2019 [Online].

https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/pdf/db2020/Doing-Business-2020_rankings.pdf

8 "Vështrim mbi Filantropinë, Buletini tremujor" Partners Albania 2019, [Online] <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/October-December-2019.pdf>



Përmbledhje Ekzekutive

Rreth Shoqërisë Civile

	2018	2019
Numri i organizatave të regjistruara (+ sa janë regjistruar në vitin 2019)	11,426 OSHC 400 OSHC të regjistruara në 2018	11,739 OSHC 313 OSHC të regjistruara në 2019
Ligjet kryesore të shoqërisë civile	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 8788 "Për organizatat jofitimprurëse" - Ligji nr. 8989 "Për Regjistrimin e Organizatave Jo - fitimprurëse" - Kodi Civil i Shqipërisë - Standardi Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jo - fitimprurëse - Ligji për të Drejtën e Informimit - Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik 	
Ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor	Ligji nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"	Jdhëzimi nr. 34, datë 02.12.2019 "Për Modifikimin e Udhëzimit Nr. 6, Datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar " (Rimbursim i TVSH-së)
Financimet shtetërore (për vitin e kaluar) (organet kryesore dhe shumat)	Për Vitin Fiskal 2018 buxheti i AMSHC-së i alokuar për OShC-të ishte 108 milion lekë (afërsisht 857,000 EUR)	Për Vitin Fiskal 2019 buxheti i AMSHC-së i alokuar për OShC-të ishte afërsisht 100 milion lekë (afërsisht 793,000 EUR).
Burimet njerëzore (të punësuar dhe vullnetarë)	8, 917 të punësuar Asnjë informacion mbi numrin e vullnetarëve	9, 966 të punësuar Asnjë informacion mbi numrin e vullnetarëve
Bashkëpunimi OShC-Shtet (organi i rëndësishëm dhe i ri: mekanizëm konsultimi)	Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile	
Sfidat e tjera kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e të dhënave dhe informacionit të saktë për sektorin e shoqërisë civile - Lehtësirat financiare dhe qëndrueshmëria e sektorit mbetet një nga pikat më të dobëta të sektorit. Sektori është i varur nga donatorët, dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e të dhënave dhe informacionit të saktë për sektorin e shoqërisë civile - Lehtësirat financiare dhe qëndrueshmëria e sektorit mbetet e dobët. Sektori është i varur nga donatorët, dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave të tyre.

Gjetjet Kryesore

Në përgjithësi, kuadri ligjor që rregullon regjistrimin e OSHC-ve është i harmonizuar në shumë aspekte të tij. Por, ai ende paraqet disa çështje problematike rreth centralizimit të procesit të regjistrimit / ri-regjistrimit në Tiranë, dhe mungesës së një regjistri elektronik me të dhëna të sakta e të plota për sektorin e OSHC-ve.

Gjithashtu, në vitin e fundit vihet re një kontroll i shtuar i institucioneve publike mbi veprimtarinë e OShC-ve përmes ligjeve të aprovuara, veçanërisht paketa për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit, që çënojnë pavarësinë e sektorit.

Në korrik 2019, qeveria shqiptare miratoi Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Dokumenti pasqyron një version të rishikuar të Udhërrëfyesit 2015-2018, ku 80% e masave të këtij të fundit nuk u zbatuan.

Krijimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile nuk ka prodhuar ndonjë diskutim produktiv për të adresuar prioritetet kryesore të OShC-ve në proceset e hartimit të politikave dhe si rezultat ka kufizuar pjesëmarrjen e gjerë dhe angazhimin e tyre në këto procese. Për më tepër, vihet re një mungesë ndërveprimi i anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill me OSHC-të e tjera që ata përfaqësojnë.

Duke iu referuar shërbimeve sociale, OShC-të janë një ndër ofruesit kryesorë të shërbimeve sociale. Sidoqoftë, kontributi i tyre nuk njihet plotësisht nga shteti, as nuk mbështetet përmes një kornize ligjore mundësuese që do të lehtësonte funksionimin dhe aksesin e tyre për fonde publike ose mbështetje të tjera publike jo-financiare.

Gjetjet kryesore të raportit

1.	Mungon regjistri elektronik me të dhëna të plota për sektorin jo-fitimpurës, i cili do të mundësonte përdorimin e tyre nga institucionet publike dhe palët e tjera të interesuara.
2.	Rritja e kontrollit të institucioneve shtetërore mbi veprimtarinë e OShC-ve, përmes miratimit të ligjeve mbi paketën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat çënojnë pavarësinë e sektorit.
3.	Strategjitë dhe mekanizmat e krijuar për bashkëpunimin Shtet-OShC (Udhërrëfyesi dhe KKShC) nuk po japin rezultatet e pritura drejt një mjedisi mundësues për shoqërinë civile, për shkak të zbatimit të dobët dhe mungesës së reflektimit rreth problematikave të sektorit.
4.	Edhe pse OShC-të janë ofruesit kryesorë të shërbimeve sociale, kontributi i tyre nuk njihet plotësisht nga shteti, dhe nuk mbështetet përmes një kuadri ligjor mundësues që do të lehtësonte funksionimin dhe aksesin e tyre në fondet shtetërore apo mbështetje të tjera jo – financiare.

Rekomandimet Kryesore

Rekomandimi kryesor lidhet me të dhënat publike për sektorin. Krijimi i regjistrit elektronik do të mundësonte të dhëna të plota, të sakta dhe të përditësuara mbi OSHC-të, për t'u përdoruar nga publiku dhe institucionet shtetërore.

Në lidhje me bashkëpunimin shtet – OShC, nevojitet një kuadër rregullator i përmirësuar dhe zbatimi korrekt i tij në praktikë, duke përfshirë edhe kuadrin të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Një rekomandim në këtë aspekt është përfshirja efektive e OSHC-ve në diskutimet dhe grupet e përbashkëta pune që në fazat e para të procesit ligjvënës, për të përgatitur projekt-ligje dhe rregullore të cilat ndikojnë në punën dhe veprimtarinë e OSHC-ve.

OSHC-të janë ofruesit kryesor të shërbimeve sociale. Për rrjedhojë, një nga rekomandimet është mbështetja përmes skemave financuese shtetërore për organizatat që ofrojnë shërbime sociale, dhe akses të lehtë të skemave të financimit dhe mekanizmave të prokurimit të fondeve publike.

Rekomandimet Kryesore	
1.	Krijimi i regjistrit elektronik do të mundësonte të dhëna të plota, të sakta dhe të përditësuara mbi OSHC-të, për t'u përdoruar nga publiku dhe institucionet shtetërore.
2.	Përfshirja efektive e OSHC-ve në diskutimet dhe grupet e përbashkëta pune që në fazat e para të procesit ligjvënës, për të përgatitur projekt-ligje dhe rregullore të cilat ndikojnë në punën dhe veprimtarinë e OSHC-ve.
3.	Zbatimi korrekt i kuadrit ekzistues ligjor dhe rregullator dhe rishikim i objektit të punës dhe modaliteteve të mekanizmave bashkëpunues midis institucioneve dhe shtetit, si një mënyrë për të reflektuar ndryshimet socio – ekonomike dhe kontekstin politik të vendit.
4.	Rritja e mbështetjes për OSHC-të që ofrojnë shërbime sociale përmes skemave shtetërore të financimit, aksesit të lehtë të skemave publike së mekanizmave të prokurimit publik.

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

1.1.1. Themelimi dhe Pjesëmarrja në OSHC

Kuadri ligjor që rregullon krijimin e OSHC-ve dhe pjesëmarrjen në to nuk ndryshoi gjatë vitit 2019. Ai u mundëson individëve të krijojnë dhe të marrin pjesë në shoqata, qendra dhe fondacione që ndjekin një qëllim/ qëllime të ligjshme. Regjistrimi nuk është i detyrueshëm.

Procesi i regjistrimit / ri-regjistrimit të OSHC-ve vazhdon të jetë i centralizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pavarësisht se është një detyrim ligjor, regjistri elektronik që do të mundësonte një bazë të dhënash të sakta për sektorin nuk është ende publik. Për më tepër, të dhënat publike të siguruar nga institucionet publike nuk janë të besueshme dhe të disponueshme në formë të unifikuar. Sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, numri i përgjithshëm i OSHC-ve të regjistruara është 11,739 nga të cilat 8,229 janë regjistruar gjatë periudhës 2001 - 2019. Gjykata nuk arriti të shpjegojë se nga vjen teprica prej 3,447 OSHC-sh. Për vitin fiskal 2019, Gjykata raporton se numri i përgjithshëm i OShC-ve të regjistruara është 313 OSHC, përkatësisht 193 shoqata, 79 qendra dhe 41 fondacione.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve raporton se numri i përgjithshëm i OShC-ve të regjistruara është 4,777 OSHC, nga të cilat 238 OSHC janë regjistruar përgjatë 2019. Asnjë informacion nuk u vu në dispozicion mbi formën e tyre të organizimit. Numri i OSHC-ve të regjistruara në Gjykatë gjatë vitit 2019 dhe numri i OSHC-ve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve tregon se pak a shumë se këto dy procese shkojnë në të njëjtin trend.

Në praktikë, regjistrimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë paraqet procedura të gjata regjistrimi për individë ose grupe që duan të krijojnë një OSHC. Sipas OSHC-ve të regjistruara përgjatë 2019 që morën pjesë në studim, vetëm 2 nga 5 OSHC pohuan se procedura e regjistrimit përfundoi brenda 15 ditësh siç parashikohet në Ligjin për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse⁹. Për 3 OShC-të e tjera, procedura e regjistrimit zgjati deri në 5 muaj. OSHC-të vlerësuan se procesi i regjistrimit është i paanshëm, por duke qenë se dokumentet e kërkuara nuk janë të qarta për të gjithë, kjo kontribuon në vonesa gjatë procesit e regjistrimit.

Detyrimi ligjor për t'u regjistruar ose ri-regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë paraqet sfida për OShC-të që kanë seli jashtë Tirane, duke e bërë të kushtueshëm dhe afatgjatë në kohë.

Në lidhje me koalicionet dhe rrjetet, kuadri ligjor nuk pengon krijimin apo pjesëmarrjen në një rrjet ose

⁹ Ligji Nr. 8789, datë 7/05/2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jo-fitimprurëse", Fletore Zyrtare 28/2001 [Online] <https://qbz.gov.al/share/8xeayD8XRvmJSqqvqVGGew>

koalicion, qofshin koalicione dhe rrjete kombëtare apo ndërkombëtare. Por, Ligji Nr. 8789, datë 7/05/2001, "Për Regjistrimin e Organizatave Jo-fitimprurëse" nuk përmban asnjë dispozitë ligjore që rregullon regjistrimin e koalicioneve dhe rrjeteve. Ata duhet të zgjedhin formën e duhur nga tre forma të organizimit të përcaktuara në ligj.

Lidhur me pjesëmarrjen e OSHC-ve në rrjete dhe koalicione, 78% nga 152 OShC të intervistuar janë anëtare në rrjete dhe koalicione vendase, ndërsa 49% e tyre janë anëtarë të rrjeteve dhe koalicioneve ndërkombëtare.

Siç vërehet, ka një tendencë në rritje të OSHC-ve për tu regjistruar në rrjete dhe koalicione. Për rrjedhojë, (siç rekomandohet edhe nga OSHC-të e intervistuar) kërkohet ndryshimi i kornizës ligjore për organizatat jo-fitimprurëse në mënyrë që të njihen rrjetet dhe koalicionet si forma ligjore organizimi. Kjo do të lehtësojë sfidat me të cilat përballen rrjetet dhe koalicionet për të përshtatur rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me kërkesat aktuale ligjore për regjistrimin e OSHC-ve.

1.1.2. Ndërhyrja e shtetit

Kuadri ligjor aktual ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në strukturën dhe procedurat e brendshme të menaxhimit të OSHC-ve. Në përgjithësi OSHC-të veprojnë lirisht dhe pa ndërhyrje të shtetit. Por, në vitin e fundit vihet re një tendencë nga qeveria për të ndërhyrë në funksionimin e OSHC-ve.

Gjatë vitit 2019, u miratua Ligji Nr.75/2019 "Për Rininë."¹⁰ Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Ligji parashikon krijimin e Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR), një organ këshillimor, që synon t'i propozojë ministrisë përgjegjëse për rininë, strategji dhe politika rinore. KKR kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe pritet të ketë në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose të rinjtë.

Ky ligj minon pavarësinë e organizatave të shoqërisë civile pasi kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të KKR, si dhe mënyra se si do të organizohet dhe do të funksionojë Këshilli Kombëtar i Rinisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë. Kjo krijon mundësinë e një varësie të drejtpërdrejtë politike të anëtarëve që vijnë nga organizatat rinore. E njëjta strukturë me të njëjtat çështje problematike pritet të krijohet në nivel vendor. Këshilli Vendor i Rinisë do të jetë një strukturë vendore ku kryetari i Bashkisë do të jetë kryetar i këshillit dhe ka autoritetin për të emëruar anëtarët e tij.

Neni më problematik në Ligj është neni 13, i cili përcakton krijimin e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, si një organizatë jo-fitimprurëse. Pika 3 e këtij neni përcakton gjithashtu se kriteret që duhet të plotësojë kjo organizatë për t'u njohur si e tillë nga ministria përgjegjëse për rininë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky nen është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën dhe Ligjin për Organizatat Jo-fitimprurëse, dhe dëmton rëndë parimet e pavarësisë dhe të organizimit të lirë së OSHC-ve.

Ligji u kundërshtua nga organizatat rinore dhe në dhjetor 2019 Presidenti nuk e dekretoi dhe ia ktheu parlamentit për përmirësime të mëtejshme ligjore. Sidoqoftë, më 27 dhjetor 2019, Parlamenti miratoi ligjin pa marrë parasysh rekomandimet e aktorëve të shoqërisë civile dhe Presidentit të Republikës.

Referuar pasqyrave financiare, kërkesa kryesore e raportimit për OSHC-të mbetet dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore në përputhje me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-fitimprurëse¹¹. Standarti përcakton specifikat e pasqyrave financiare dhe formatin e raportimit të OShC-ve, dhe paraqet

¹⁰ Ligji Nr. 75/2019 "Për Rininë", Gazeta Zyrtare 171/2015 180/2019 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/180/7d10ef94-7c6e-4988-8c5d-362df7023217?q=Ligji%20per%20rinine>

¹¹ Udhezim Nr. 62, datë 17.09.2015 "For Shpalljen e Standartit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe zbatimi i detyrueshëm i tij", Ministria e Financës, Gazeta Zyrtare 171/2015 [Online] https://qbz.gov.al/share/msVHnvi8QI-INGH_26ccqQ

kërkesa të thjeshtuara për raportim për organizatat me të ardhura vjetore nën pesë milion lekë (rreth 3,700 EUR). Këtyre organizatave u kërkohet të zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe të ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënime shpjeguese lidhur me llojin e aktiviteteve apo shërbimeve që ofrojnë. Ligji 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"¹² paraqet kërkesa të reja për OShC-të nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare është mbi vlerën 30 milionë lekë (afërsisht 235,000 EUR). Këto OSHC duhet të përgatitin një raport të performancës në lidhje me veprimtarinë e tyre, i cili do të publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Format i raportit është ende në diskutim dhe pritet të publikohet brenda vitit 2020 nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Për më tepër, këto OSHC janë të detyruara t'i paraqesin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pasqyrat financiare, edhe pse Gjykata nuk ka një mandat institucional për të menaxhuar dhe përdorur këtë lloj informacioni.

Organizatave e Shoqërisë Civile i nënshtrohen kontrollit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe kontrollit operacional. Gjatë vitit 2019, u ndërmorën disa nisma dhe ndryshime ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. U miratua Ligji Nr. 33/2019 i cili paraqet ndryshime dhe shtesa të Ligjit Nr. 9917 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹³. Gjithashtu u miratua Udhëzimi Nr. 19, datë 9.7.2019 "Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në Funkcion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit".¹⁴ Ky udhëzim rregullon procedurat që ndiqen nga organet tatimore, si organ mbikëqyrës, për kontrollin e veprimtarisë së OSHC-ve, me qëllim shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim terrorizmi. Udhëzimi synon unifikimin dhe vendosjen e standarteve bashkëkohore për të garantuar saktësi në dërgimin e informacionit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), me qëllim identifikimin e rasteve të dyshimta për pastrim parash apo financim terrorizmi të OSHC-ve.

Udhëzimi përmban 38 indikatorë rrisht të riskut me qëllim vlerësimin e riskut të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave që lidhen me sektorin jofitimprurës. Ky udhëzim pasqyron masat e vendit në përbushje të rekomandimeve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, por rrit kontrollin e institucioneve shtetërore mbi veprimtarinë e OSHC-ve dhe cënon pavarësinë e sektorit. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë vitit 2019 janë inspektuar nga autoritetet tatimore 12 OSHC.

Gjatë vitit 2019 nuk pati ndryshime ligjore rreth shpërbërjes së OSHC-ve. Ligji për Organizatat Jofitimprurëse i ndryshuar¹⁵ dhe Ligji për Procedurat Tatimore, i ndryshuar¹⁶, rregullojnë shpërbërjen apo ndërprerjen e veprimtarisë së OSHC-ve. Siç është përmendur dhe në Raportin e MM 2018¹⁷, një nga çështjet sfiduese në lidhje me shpërbërjen është fakti që ligji konsideron ligjërishit përgjegjës përfaqësuesin ligjor të OSHC-së dhe lejon Administratën Tatimore të mbledhë borxhet ose taksat e papaguara, edhe pas ç'regjistrimit të OSHC-së në Gjykatë. Mbetet e paqartë se si organet tatimore mund ta bëjnë këtë gjë pasi i njëjti ligj kërkon që ç'regjistrimi të bëhet në Gjykatë vetëm pasi OSHC-ja të ketë paguar të gjitha borxhet dhe detyrimet e saj kundrejt autoriteteve tatimore. Në bazë të të dhënave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjithsej janë 150 OSHC të ç'regjistruara në Gjykatë, ndërsa sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjithsej janë 177 OSHC që janë ç'regjistruar ose në proces ç'regjistrimi tek autoritetet tatimore.

¹² Ligji Nr. 25/2018 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Gazeta Zyrtare 79/2018 [Online]. https://qbz.gov.al/share/msVHnvi8QI-INGH_26ccqQ

¹³ Ligji Nr. 33/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar", Fletore Zyrtare 99/2019 [Online] <https://qbz.gov.al/share/sC4WmeBESCK2tXgkknal7ë>

¹⁴ Udhëzimi Nr. 19, datë 9.7.2019 "Për Mbikëqyrjen E Organizatave Jofitimprurëse Në Funkcion Të Parandalimit Të Pastrimit Të Parave Dhe Financimit Të Terrorizmit", [Online] <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=6345>

¹⁵ Ligji nr 8788, datë 07/05/2001, ""Për organizatat jofitimprurëse"", i ndryshuar Kapitulli VII, Fletore Zyrtare 36/2013 [Online] https://qbz.gov.al/share/s0AXcHUmTAm53LiuW_wbpQ

¹⁶ Ligji Nr. 97/2018, datë 3.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" Fletore Zyrtare 187/ 2019, [Online] <https://qbz.gov.al/share/dfCkGpG0Qtaj-P4xOxC3xQ>

¹⁷ "Raporti i Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile për Shqipërinë, Maj 2018 - Maj 2019" Partners Albania [Online] <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-Matrix-Country-Report-for-Albania-2018.pdf>

Përsa i përket praktikës, shumica e OSHC-ve të intervistuar u shprehën se organizatat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur dhe nuk janë ndëshur me ndërhyrjen e shtetit në veprimtarinë e tyre të brendshme. Vetëm 2 nga 152 OSHC të intervistuar u shprehën se janë përballur me kontrolle inspektimi nga autoritetet publike pa njoftim paraprak.

Sa i përket sanksioneve të aplikuara, 10% e OShC-ve të intervistuar shprehen se kanë qenë subjekt i sanksioneve nga autoritetet shtetërore. Sanksionet zbatohen në formë të gjobave dhe kryesisht kanë të bëjnë me vonesat e deklarimeve online të taksave. Nga ky kampion i OSHC-ve, 73% e tyre deklaruan se sanksionet ishin proporcionale me shkeljet.

Të pyetur mbi mundësinë për të apeluar vendimin në Gjykatë, përgjigjet tregojnë se OShC-të e njihnin këtë të drejtë, por vetëm 50% e tyre e kanë ushtruar atë.

1.1.3. Sigurimi i burimeve financiare

OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë të ardhura financiare për aktivitetet e tyre nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, pa miratim dhe vlerësim paraprak nga shteti. Legjislacioni në fuqi lejon OShC-të të angazhohen në veprimtari ekonomike, të marrin fonde të huaja dhe mbështetje financiare nga korporatat. Dhurimet individuale nuk janë të ndaluara me ligj dhe si rrjedhojë OSHC-të marrin dhurime nga individë, megjithëse për të tilla dhurime mungojnë përfitimet tatimore.

Në lidhje me aktivitetin ekonomik, OSHC-ve në Shqipëri u lejohej të gjenerojnë të ardhura nga pagesa për shërbime, shitje, qera, etj. Aktiviteti ekonomik nuk duhet të jetë aktiviteti primar i OSHC-ve (aktiviteti jo-ekonomik duhet të mbizotërojë) dhe të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale.

Në bazë të Ligjit Nr. 65/2016, datë 09.06.2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë"¹⁸, OSHC-të janë entiteti i vetëm që kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si ndërmarrje sociale pas marrjes së statusit. Udhëzimi Nr. 607, datë 01.08.2018 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,¹⁹ përcakton procedurën dhe dokumentet që OSHC-të duhet të dorëzojnë në mënyrë që të përfitojnë statusin e ndërmarrjeve sociale. Udhëzimi nuk parashikon të drejtën e ankimimit në rastin kur një OSHC-je i refuzohet marrja e statusit nga komiteti i vlerësimit.


Gjithashtu, ligji për Ndërmarrjet Sociale (NS) i jep të drejtën pushtetit vendor të marrë pjesë në organin vendimmarrës të ndërmarrjes sociale. Këto kritere, përfshirë edhe përcaktimin e nivelit të pagës si kusht që të përfitojë statusin e NS dhe ushtrojë aktivitetin si NS me fonde publike, jo vetëm që limitojnë hapësirën e NS për të ushtruar aktivitetin e tyre, por i kthen ato në ndërmarrje të kontrolluara nga shteti.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë vitit 2019 kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale 6 OSHC nga 9 që kanë aplikuar, duke ushtruar aktivitetin e tyre si NS.

¹⁸ Ligji Nr. 65/ 2016, datë 09/06/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë", Fletore Zyrtare 118/2016, [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/09/65-2016>

¹⁹ Udhëzimi Nr. 607, datë 01.08.2018, "Mbi procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale" [Online] W<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Udhezim-Nr.607-dt-01.08.2018-PER-MARRJEN-E-STATUSIT-TE-NDERMARRJES-SOCIALE.docx>

Figura 1: Burimet e të ardhurave në vitin 2019 të OSHC-ve të intervistuar



Për vitin fiskal 2019, burimi kryesor i të ardhurave për OSHC-të e intervistuar mbeten institucionet e huaja donatore, të cilat sigurojnë 62% të burimeve të të ardhurave totale, ndërsa fondet nga Bashkimi Evropian përbëjnë 51% të fondeve totale.

Një pjesë e financimit të BE-së, përmes fondeve IPA koordinohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë (CFCU), e cila është struktura përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin indirekt të fondeve IPA, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë.

Bazuar në informacionin e publikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 12 kontrata grantesh janë firmosur me OSHC-të në kuadër të Programit EU IPA 2014-20 në Dhjetor 2018 me një fond total prej 757,949.14 EU, dhe 13 kontrata grantesh në kuadër të EU IPA Programi 2015²¹ me një fond total prej 647,359.63 EUR.

Bazuar në informacionin e dhënë nga OSHC-të fituese të skemës EU IPA 2014, procesi i aplikimit zgjati gati dy vite, nuk pati seanca orientuese me fituesit dhe instruksionet mbi zbatimin dhe raportimin u dhanë në përfundim të zbatimit të projekteve. Këto çështje u adresuan në thirrjen e skemës EU IPA 2015, duke rezultuar në një përmirësim të lehtë në lidhje me procesin e aplikimit dhe zbatimit. Bazuar në përvojën e përfituesve të granteve, CFCU është perceptuar më shumë si një institucion ndërlidhës midis përfituesve dhe BE-së, pa qartësi mbi kompetencat dhe autoritetin e saj dhe jo e gatshme të mbajë përgjegjësi mbi veprimet dhe udhëzimet e dhëna për përfituesit e granteve. Përfituesit e granteve nuk kanë marrë përgjigje institucionale mbi pyetjet e ngritura dhe evidentohet një mangësi besimi dhe pasigurie për të diskutuar dhe dhënë përgjigje mbi çështjet dhe pyetjet e ngritura në lidhje me zbatimin e projekteve të financuara, duke rezultuar në përgjigje evazive dhe të paqarta. Në shumicën e rasteve është pritur

²⁰ Informacioni është marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme [Online] <https://punetejashtme.gov.al/en/grant-contracts-awarded-during-december-2018/>

²¹ Informacioni është marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme [Online] <https://punetejashtme.gov.al/en/grant-contracts-awarded-during-september-2019/>

miratimi nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, duke rezultuar në vonesa dhe pengesa në punën e përfituesve dhe paqartësive nëse vendimet janë marrë nga CFCU dhe/apo BE.

Një çështje tjetër e identifikuar nga përfituesit ka të bëjë me rolin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si autoriteti koordinues për programin EU IPA. Ekziston paqartësi tek përfituesit mbi detyrimet që ata kanë ndaj Ministrisë dhe rolit të Ministrisë në veprimtaritë e tyre, për sa i përket vizibilitetit, monitorimit dhe vlerësimit.

Gjithashtu, promovimi dhe lehtësimi i komunikimit dhe rrjetëzimit ndërmjet përfituesve nga CFCU dhe Ministrisë konsiderohet e rëndësishme në mënyrë që përfituesit e granteve të ndajnë dhe diskutojnë përvojat e tyre, sfidat, mësimet e nxjerra dhe rritjen e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit midis përfituesve.

Nën- fusha 1.2. Liri të Tjera

1.2.1. Liria e Tubimeve Paqësore

Pavarësisht përmirësimeve gjatë vitit 2018 me miratimin e procedurës së brendshme nga Policia e Shtetit në lidhje me tubimet, bazuar edhe në rekomandimet e Avokatit të Popullit, ka ende disa çështje që duhet të adresohen përmes ndryshimeve ligjore për të siguruar plotësisht lirinë e tubimit. Ligji "Për Tubimet"²² është ligji primar që rregullon organizimin paqësor të tyre. Sikundër është theksuar edhe në raportet e mëparshme të MM, ligji ka nevojë për ndryshime të tjera që do qartësonin konfuzionin ndërmjet termave njoftim dhe kërkesë/leje, sikundër citohet në disa nene të tij. Gjithashtu duhet të adresojë të drejtën për tubime spontane dhe kundër –protestat, si dhe krijimin e formave të njoftimit online për të mundësuar procedurën e njoftimit nëpërmjet internetit.

Në praktikë, gjatë vitit 2019 në Shqipëri janë organizuar shumë protesta.. Natyra e tyre ishte e ndryshme, si: advokimi për një kuadër ligjor të përmirësuar në arsim, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e mjedisit, etj. Gjithashtu, për shkak të situatës së tensionuar politike, shumë protesta u organizuan kundër qeverisë. Vala e këtyre protestave vazhdoi për disa muaj, e ndërsa disa prej tyre ishin paqësore, të tjerat u kthyen në të dhunshme, me protestues që hidhnin objekte tek institucionet publike dhe forcat policore. Shpeshherë forcat e policisë përdorën gaz lotsjellës për të shpërndarë protestuesit.²³

Bazuar në përgjigjet e OSHC-ve të intervistuar, 49% e tyre kanë marrë pjesë në një tubim paqësor, qoftë si organizatorë apo si pjesëmarrës, 39% e tyre kanë marrë pjesë në tubime të njëkohshme dhe 7% në tubime spontane. Autorizimi paraprak nga Policia e Shtetit për të organizuar një tubim vlerësohet si pengesë nga OSHC-të e intervistuar.

1.2.2. Liria e Shprehjes

Gjatë vitit 2019, Qeveria e Shqipërisë hartoi paketën ligjore kundër shpifjes që rregullon mediat elektronike.

Projekt ligjet detyrojnë portalet online të konsiderojnë çdo ankesë me shkrim nga çdo lexues mbi lajmin e publikuar në portal, përfshirë edhe kërkesën për fshirjen e lajmit. Në rast se portali elektronik rrëzon kërkesën apo nuk jep përgjigje brenda 72 orëve, atëherë lexuesit i lind e drejta të ankohet tek Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA). Është në kompetencën e AMAs-s ta shqyrtojë dhe të vendosë sanksione nëse

²² Ligji Nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet" Gazeta Zyrtare 23/2001 [Online]
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf

²³ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të organizatës CIVICUS [Online]
<https://monitor.civicus.org/updates/2019/05/20/tirana-witnesses-violent-protests-anger-spills-streets/>

vendimi i dhënë prej saj nuk është në linjë me përgjigjen e dhënë nga portali online. Standartet Ndërkombëtare dhe praktikat më të mira mbi lirinë e medias dhe çështjet etike, siç është e drejta për t'iu përgjigjur një ankese, inkurajojnë vetë-rregullimin mbi këto çështje.

Paketa u kundërshtua gjerësisht nga komuniteti i gazetarëve dhe i organizatave të drejtave të njeriut, sipas të cilave projektligjet e propozuara zgjerojnë rolin e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) duke u dhënë atyre kompetenca pothuajse gjyqësore, me një natyrë sanksionuese kundrejt mediave. Paketa anti-shpifje u kundërshtua edhe nga organizatat e media si një dhunim i së drejtës së lirisë së shprehjes. Ato, përgjatë vitit 2019 ato publikuan 3 deklarata publike për të adresuar në lidhje me sanksionet dhe gjobat, të cilat sipas tyre janë jo-proporcionale dhe masat janë drastike.

Edhe organizatat ndërkombëtare reagues për paketën ligjore. Zyra e Përfaqësimit të OSBE-së për Lirinë e Medias, publikoi një analizë të projektligjeve, duke paraqitur disa rekomandime për përmirësime të mëtejshme²⁴. Megjithatë, paketa u aprovua nga Parlamenti në 19 dhjetor 2019, por Presidenti nuk e dekretoi Ligjin dhe e ktheu atë për përmirësime të mëtejshme. Pas kësaj, dhe pas presionit nga organizatat kombëtare dhe institucionet ndërkombëtare, Parlamenti u tërhoq nga rishikimi i mëtejshëm i tij dhe Komiteti Monitorues i Parlamentit Shqiptar kërkoi opinionin e Komisionit të Venecias në lidhje me këtë paketë²⁵. Opinioni i Komisionit të Venecias pritet të dalë në fund të marsit 2020.

Shpifja mbetet vepër penale, megjithëse nuk dënohet me burgim.²⁶

Intervistat me OSHC-të nuk dëshmojnë ndonjë shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes. Sidoqoftë, organizatat e mediave shprehin shqetësim për presionin e ushtruar ndaj gazetarëve nga qeveria dhe zyrtarët publik në rastet e mendimeve të kundërta dhe artikujve kundër qeverisë.

1.2.3. Aksesi në burimet e informacionit

Kuadri ligjor nuk përmban kufizime në lidhje me përdorimin e platformave online dhe internetit. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar ²⁷përcakton garanci specifike për mbledhjen e të dhënave personale, ruajtjen, publikimin dhe transferimin e informacionit të përdoruesve. Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nëpër shtëpi nga individët tregojnë se numri i njerëzve që përdorin internetin është rritur gjatë vitit 2019²⁸, ku 82.2% e familjeve shqiptare kanë akses në internet.

OSHC-të në vitet e fundit po përdorin gjithnjë e më shumë mediat sociale dhe krijimin e platformave online për të informuar dhe komunikuar me publikun dhe për të advokuar për çështje të ndryshme. Sipas raportit të Qendrës Kombëtare Burimore,²⁹ kanalet e komunikimit dhe mjetet më të përdorura nga organizatat për të informuar dhe bashkëvepruar me publikun e gjerë janë media sociale, konkretisht Facebook në 90% të rasteve, faqja zyrtare e internetit të organizatave për 56.5% të organizatave si dhe si media audiovizuale lokale në 55% të rasteve.

²⁴ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të OSBE-së [Online] <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/425462?download=true>

²⁵ Informacioni është marrë nga Radio Televizioni Shqiptar Online] <http://rti.rtsh.al/2020/01/23/anti-defamation-package-to-be-reviewed-by-venice-commission-in-march/>

²⁶ "Paketa e Zgjerimit të BE-së 2018 - Liria e Shprehjes - Shoqëria e Informacionit dhe Media, Komisioni Evropian, 2018. [Online] https://euwesternbalkansmediadays.eu/images/FREEDOM_of_EXPRESSION_INFO_SOCIETY_AND_MEDIA_2018.pdf

²⁷ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (me Ligjin Nr. 48/2012 (Gazeta Zyrtare 53/2012) dhe me Ligjin Nr. 120/2014 (Gazeta Zyrtare 160/2014), [Online] https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/fletepalosje_ligji_per_mbrojtjen_e_te_dhenave_personale.pdf

²⁸ "Si shqiptarët përdorin internetin sot?", Invert in Albania [Online] <https://invest-in-albania.org/how-albanians-use-the-internet-today/>

²⁹ "Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri", Partners Albania for Change and Development 2019, [Online] <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2019/12/Need-Assessment-Report-2019.pdf>

Kutia 1: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikës

- Sa i përket funksionimit të OShC-ve, ekziston një tendencë për ndërhyrje nga shteti në veprimtarinë e OShC-ve, siç reflektohet në disa nga ligjet e miratuara së fundmi, si: Ligji për Rininë, Ligji për Ndërmarrjet Sociale dhe Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

- Në lidhje me lirinë e tubimeve, Ligji Nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për Tubimet" duhet të ndryshohet, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të lirisë së tubimeve në lidhje me dhe procedurën e njoftimit online, dhe rregullimin e tubimeve spontane dhe kundër - tubimeve.

- Për sa i përket lirisë së shprehjes, paketa e re ligjore kundër shpifjes e prezantuar dhe miratuar nga parlamenti, i jep kompetenca të reja shtesë AMA-s që janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe kundërshtohen gjerësisht nga organizatat e mediave dhe madje edhe institucionet ndërkombëtare.

1.1.c. Progresi në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës

- Pavarësisht se është një detyrim ligjor, regjistri elektronik i OShC-ve që do të mundësonte të dhëna të plota për sektorin nuk është ende i disponueshëm, duke rezultuar në të dhëna jo të besueshme nga institucionet publike dhe jo të disponueshme në një formë të unifikuar.

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OShC-të

Nën-fusha 2.1. Trajtimi tatimor / fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

2.1.1. Përfitimet tatimore

Në dhjetor të vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikoi një udhëzim mbi procedurën e rimbursimit të TVSH-së rreth fondeve të donatorëve të huaj për OShC-të³⁰. Me zbatimin e këtij udhëzimi, të gjitha marrëveshjet bilaterale dhe shumëpalëshe të ratifikuara nga Parlamenti shqiptar ose marrëveshjet të miratuara nga Këshilli i Ministrave, kualifikohen për rimbursim të TVSH-së. Gjithashtu, subjekt i rimbursimit të TVSH-së janë skemat e nën-grantimit të zbatuara përmes organizatave ndërmjetësuese. Ky është një hap i madh drejt përmirësimit të rregullimit ligjor për rimbursimin e TVSH-së dhe është rezultat i përpjekjeve advokuese të sektorit në këtë drejtim.

Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë lëshuar 12 certifikata për rimbursimin e TVSH-së për projektet IPA, por nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin aktual të rimbursimeve të zbatuara të TVSH-së.

Aktiviteti i OSHC-ve vazhdon të mbetet subjekt i TVSH-së, ndërsa mallrat dhe shërbimet që lidhen me ndihmën dhe kujdesin shoqëror, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, sportin dhe edukimin fizik, kulturën dhe edukimin, përjashtohen nga TVSH-ja. Përjashtimi nga taksat për këto mallra dhe shërbime kryhet në bazë të kriterëve të përcaktuara që OSHC-të duhet të përmbushin, dhe rregullohen me vendim të qeverisë³¹.

OSHC-të mund të kryejë veprimtari ekonomike e cila duhet të jetë në përputhje me misionin e tyre dhe aktiviteti ekonomik nuk është aktiviteti kryesor i tyre. Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore të OSHC-së dhe nëse kjo shumë e tejkalon kufirin e regjistrimit të TVSH-së, atëherë organizatat regjistrohen për TVSH në përputhje me Ligjin për Procedurat Tatimore. Megjithatë kuadri ligjor i lejon OSHC-ve të kërkojnë rimbursimin e TVSH, kjo është praktikisht e pamundur, për shkak të karakterit jo të vazhdueshëm të veprimtarisë së OSHC-ve ato nuk mund të përmbushin dy kushte bazë për të kërkuar rimbursim: (1) tepriçë kreditore e mbartur për tre muaj të njëpasnjëshëm, dhe (2) shuma e kërkuar për rimbursim duhet të jetë më e madhe se 400,000 lekë (afërsisht 3,000 EUR).

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë 1,562 OSHC të regjistruara për raportimin e TVSH-së. Në krahasim me Raportin e MM 2018 numri është rritur pothuajse 4-fish.

Referuar taksave vendore, në përgjithësi nuk ka trajtim të diferencuar për OSHC-të, duke marrë parasysh natyrën e tyre jo-fitimprurëse, misionin, modelin e financimit, mënyrat e funksionimit dhe përfituesit. Shumica e bashkive të mëdha zbatojnë të njëjtat nivele tatimore për OShC-të si për bizneset.

Në lidhje me ndërmarrjet sociale dhe duke iu referuar kushteve financiare, bazuar në Ligjin 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë"³² ndërmarrja sociale është e detyruar të përdorë ... "të gjithë fitimin (bilancin pozitiv) për zhvillimin dhe zgjerimin e saj, e cila tatohet në të njëjtin nivel sipas legjisllacionit të tatimit mbi të ardhurat.


³⁰Udhëzimi Nr. 34, datë 02.12.2019 "Për Një Ndryshim Në Udhëzimin Nr. 6, Datë 30.1.2015 "Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar Në Republikën E Shqipërisë", i Ndryshuar Fletorja Zyrtare 169/2019 http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Udhëzim_34_5.12.2019_per_TVSH_FZ-2019-169.pdf

³¹ Vendimi Nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Dispozitat Zbatuese Të Ligjit Nr. 92/2014, "Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar Në Republikën E Shqipërisë", i Ndryshuar. [Online] <https://www.tatime.gov.al/eng/shkarko.php?id=707>

³² Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë" Gazeta Zyrtare 118/2016 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/liqj/2016/06/09/65-2016>

Qëndrueshmëria dhe lehtësirat financiare mbeten ndër aspektet më të dobëta të OSHC-ve në Shqipëri. Siç tregohet në Fig. 2, 28% e OShC-ve të intervistuar kanë një buxhet vjetor prej më pak se 5,000 EUR, ose nuk kanë fonde (15% e OSHC-ve pa fonde dhe 13% më pak se 5000 EUR).

Figura 2: Të ardhurat vjetore të OSHC-ve të intervistuar në vitin 2019




Vetëm tre organizata kanë një buxhet vjetor më të lartë se 1,000,001 EUR dhe ato janë të gjitha degë të organizatave ndërkombëtare, duke shërbyer gjithashtu si organizata ndërmjetëse të skemave të nën-grantimit për institucionet më të mëdha donatore.

28% e OShC-ve të intervistuar që deklaruan një buxhet vjetor ndërmjet 100,001 dhe 500,000 EUR janë organizata që ofrojnë shërbime sociale dhe mbështetje për grupet e pafavorizuara dhe njerëzit me nevoja të veçanta, dhe 82% e buxhetit të tyre vjen nga skemat e financimit të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare.

Vetëm 21 nga 152 OSHC të intervistuar janë të angazhuara në veprimtari ekonomike, nga të cilat 67% deklarojnë se kryejnë aktivitetin ekonomik pa asnjë pengesë, 38% përballen me kërkesa të tepërta administrative për të marrë një licencë, dhe 29% kanë vështirësi në kuptimin e rregullave të komplikuar të kontabilitetit.

Në përgjithësi, OSHC-të e intervistuar raportojnë paqartësi dhe konfuzion në lidhje me interpretimin e kuartrit ligjor mbi ndërmarrjet sociale dhe procedurat e rimbursimit të TVSH-së.

Figura 3: Përvoja praktike e OSHC-ve që ushtrojnë veprimtari ekonomike



Për sa i përket trajtimit fiskal, 67% e OShC-ve të intervistuar deklarojnë se ato nuk kanë qenë subjekte të përfitimeve tatimore. Vetëm 15% e OSHC-ve të intervistuar, kryesisht ato që ofrojnë shërbime sociale, kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja.

2.1.2. Lehtësirat mbi dhurimet individuale dhe korporatave

Kuadri ligjor për dhurimet individuale dhe të korporatave nuk ndryshoi gjatë vitit 2019. Ligji i vetëm që rregullon dhurimet është Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar³³. Sipas këtij ligji sponsorizues janë vetëm ato " *subjekte që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj apo me kapital të përbashkët.*" dhe masa e sponsorizimit njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3% të fitimit para tatimit, dhe 5% të fitimit para tatimit për botuesit e shtypit dhe botimet letrare, shkencore dhe enciklopedike, si dhe aktivitete kulturore, artistike dhe sportive. Dhurimi individual nuk njihet në ligjin për sponsorizimet ose ndonjë ligj tjetër, dhe si rezultat nuk është i rregulluar dhe nuk i nënshtrohet ndonjë trajtimi fiskal.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit nisi një propozim për të ndryshuar Ligjin për Sponsorizimet. Propozimi i referohet vetëm aktiviteteve sportive. Sipas projektligjit, për sponsorizimet në rastet e sporteve ekipore më të përhapura, u njihet zbritja deri në 20 për qind nga tatimi i fitimit; dhe për sponsorizimin e sporteve të tjera, zbritja është deri në 10% e tatimit mbi fitimin. Nisma pritet të konsultohet në vitin 2020.

³³ Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar, Fletore Zyrtare 130/ 2007 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2007/09/20/9807/d3730c57-27d0-4a54-85d2-ead691eb9f45;q=Ligj%20per%20sponsorizimet>

Në tetor të vitit 2019, Kryeministri shpalli qëllimin e qeverisë³⁴ për të krijuar një fond filantropik për të adresuar problemet e njerëzve në nevojë. Fondi quhet **# Shqipëria Solidare**, i cili do të krijohet me kontribut nga sektori privat dhe do të bashkë-menaxhohet nga sektori privat dhe qeveria. Propozimi i qeverisë është që pronarët e bizneseve (jo entiteti i biznesit) duhet të kontribuojnë me një përqindje të caktuar nga fitimi i tyre. Por, për momentin asnjë nismë ligjore nuk ka filluar për këtë qëllim.

Të dhënat nga monitorimi mediatik i veprimtarisë filantropike në Shqipëri, realizuar nga Partnerët Shqipëri, tregojnë një rritje me 94% të vlerës së përgjithshme të dhurimeve private për vitin fiskal 2019 krahasuar me një vit më parë, me një shumë totale prej 1.555.626.791 lekë (afërsisht 12,545,377.35 EUR). Korporatat gjatë vitit fiskal 2019 dhuruan një shumë totale prej 518,599, 556 lekë (afërsisht 4,182,254,48 EUR), ndërsa individët dhuruan një shumë totale prej 122.916,858 lekë (afërsisht 991,265 EUR). Përqindja e lartë e dhurimeve është e lidhur me tërmetin që goditi Shqipërinë në Nëntor të vitit 2019, pasi dëshmohet një numër më i madh i dhurimeve gjatë muajve nëntor - dhjetor 2019. Fushat kryesore të dhurimeve janë: mbështetja ndaj grupeve të marginalizuara, fatkeqësitë natyrore (e ndikuar nga tërmeti në muajin nëntor) dhe lehtësimi i varfërisë. Vlera e dhurimeve nga OSHC-të për vitin fiskal 2019 është rritur me 10%, me një shumë totale prej 13,728,930 (afërsisht. 110,000 EUR). Duke marrë në konsideratë metodologjinë e limituar, kjo shifër mund të mos përfaqësojë shumën totale të dhurimeve në vend. Si e tillë, krahasimi mund të mos jetë tërësisht i saktë.

³⁴ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit e Agjencisë Telegrafike Shqiptare [Online] <https://ata.gov.al/2019/10/03/video-rama-me-biznesin-e-madh-fondi-i-shqiperise-solidare-nje-ide-te-ciles-i-ka-ardhur-koha/>

Kutia 2: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

2.2. a. Numri dhe lloji i dhurimeve për OShC-të nga donatorë privatë dhe nga korporatat (specifikuar në vlerë monetare)

- Të dhënat nga monitorimi mediatik i veprimtarisë filantropike në Shqipëri tregojnë një rritje me 94% të shumës së përgjithshme të dhurimeve private për vitin fiskal 2019 në krahasim me një vit më parë, me një shumë totale prej 1.555.626.791 lekë (afërsisht 12,545,377,35 EUR). Korporatat gjatë vitit fiskal 2019 dhuruan një shumë totale prej 518,599, 556 lekë (afërsisht 4,182,254,48 EUR), ndërsa individët dhuruan një shumë totale prej 122.916,858 lekë (afërsisht 991,265 EUR). Duke marrë në konsideratë metodologjinë e limituar, kjo shifër mund të mos përfaqësojë shumën totale të dhurimeve në vend. Si e tillë, krahasimi mund të mos jetë tërësisht i saktë.

2.3. a. Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për aktivitetet operacionale dhe ekonomike të OSHC-ve.

- Rimbursimi i TVSH-së mbetet një nga sfidat kryesore të OSHC-ve. Edhe pse në parim ato janë të lejueshme nga ligji, pretendimi i rimbursimit të TVSH-së për OSHC-të është praktikisht i pamundur, për shkak të pragut minimal të vlerës së TVSH-së së kërkuar, dhe karakterit të vazhdueshëm të veprimtarisë ekonomike.

- Një hap i madh përpara në përmirësimin e kuadrit fiskal për OShC-të, është udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi procedurën e rimbursimit të TVSH-së për të gjitha grantet e donatorëve të huaj, për marrëveshjet financiare që janë të ratifikuara nga Parlamenti apo marrëveshjet për grantet të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Procedura e përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e klasifikuara "me interes publik" nuk funksionoi dhe shumë pak OShC përfituan nga kjo. Procedura është e gjatë dhe jo shumë e qartë, gjë që ka krijuar hezitim në sektor për ta përdorur atë.

- Sa i përket taksave vendore, në përgjithësi nuk ka trajtim të diferencuar për OShC-të, duke marrë parasysh natyrën e tyre jo-fitimprurëse, misionin, modelin e financimit, mënyrat e funksionimit dhe përfituesit.

Nën-fusha 2.2. Mbështetja e shtetit

2.2.1. Financimi Publik është i vlefshëm

Kuadri ligjor që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional të OShC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE nuk ndryshoi gjatë vitit 2019. Gjatë monitorimit, për vitin fiskal 2019 u identifikuan këto burime financimi nga institucionet publike siç reflektohet në tabelën 1.

Tabela 1: Burimet e financimit publik për OSHC-të

Institucionet	Numri i thirrjeve për projekt propozime	Aplikimet në total	OSHC-të e përzgjedhura	Viti Fiskal 2019
AMSHC	1	161	52	100 milion lekë (përafërsisht 793,000 EUR)
Ministria e Kulturës	1	91	63	27,486,212 lekë (përafërsisht 220,000 EUR).
Fondi i Lotarisë Kombëtare	1	N/A	6	N/A
AAPSK	1 ³⁵	N/A	N/A	95 milion lekë (përafërsisht 754,000 EUR)
ReLOaD	2	N/A	69	1,130,952 EUR ³⁶

Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

AMSHC është mekanizmi kryesor në nivel kombëtar që ofron mbështetje financiare për OShC-të. Mandati i AMSHC-së është të mbështesë zhvillimin institucional të shoqërisë civile në vend, të sigurojë fonde për nismat sektoriale në përputhje me strategjinë e tij të hartuar përmes një procesi konsultativ me sektorin dhe të sigurojë bashkë-financim për projektet e financuara nga BE-ja.

Për vitin fiskal 2019, buxheti i AMSHC-së në grante për OShC-të ishte afërsisht 100 milion lekë (afërsisht 793,000 EUR). Krahasuar me një vit më parë, ka një rënie të vogël të fondeve të ndara për sektorin me rreth 8,000,000 lekë (afërsisht 63,500 EUR). Sipas përgjigjes së marrë nga AMSHC-së ndaj kërkesës për informacion të dërguar nga PSH, në thirrjen e hapur për projekt propozime për vitin 2019 aplikuan 161 OSHC, nga të cilat 45 OSHC u shpallën fituese,³⁷ ndërsa sipas informacionit në faqen zyrtare të internetit të AMSHC-së janë 52 OSHC të cilat janë shpallur fituese në këtë thirrje të hapur për projekt propozime³⁸ Thirrja nuk përcaktonte një shumë minimale apo maksimale të madhësisë së grantit, por duke gjykuar nga lista e publikuar e përfituesve, shuma minimale e grantit ishte 700.000 lekë (afro 5,500 EUR), ndërsa ajo maksimale 3,000,000 lekë (afërsisht 24,000 EUR).

³⁵ Thirrja për projekt propozime është përgatitur por nuk u shpall gjatë vitit 2019. Pritet që të shpallet në vitin e ardhshëm.

³⁶ Kjo e dhënë është e dhëna totale e skemës së granteve.

³⁷ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile [Online] <http://www.amshc.gov.al/ëeb/thirrje/12/>

³⁸ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile [Online] <http://www.amshc.gov.al/ëeb/thirrje/12/Lista%20e%20projekteve%20fituese%20-%20Th12.pdf>

Në vitin 2019 Agjencia nuk akordoi grant për mbështetje institucionale, apo bashkë- financim për projektet e financuara nga BE.

Ministria e Kulturës

Një burim tjetër financimi publik për OSHC-të është Ministria e Kulturës, e cila çdo vit shpall një thirrje për projekt propozime dhe fton individë dhe OSHC të paraqesin projekt propozime në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Ministria, buxheti i përgjithshëm i ndarë përmes thirrjes për projekt propozime për vitin fiskal 2019 ishte 27,486,212 lekë (afërsisht 220,000 EUR).

Në total aplikuan 91 OSHC, nga të cilat 63 OSHC morën mbështetje financiare. Shuma minimale e grantit ishte 200,000 lekë (rreth 1.500 EUR), ndërsa shuma maksimale 1.000.000 lekë (afërsisht 8,000 EUR).

Fondi i Lotarisë Kombëtare

Gjatë vitit 2019 fondi i Lotarisë Kombëtare shpalli një thirrje për projekt propozime. Në bazë të të dhënave zyrtare të vëna në dispozicion³⁹ 8 projekt propozime u përzgjedhën, ndër të cilat 6 projekt propozime ishin nga organizatat e shoqërisë civile. Nuk ka informacion mbi shumën e mbështetjes financiare të dhënë dhe fokusin e projekteve të financuara.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AASPK)

Siç përcaktohet në ligjin 39/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara"⁴⁰ Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ka të drejtë të krijojë një fond të veçantë të aprovuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen dhe alokimin e tij tek subjektet dhe OSHC-të⁴¹. Në vitin 2019 Agjencia planifikoi një fond të përgjithshëm prej 95 milion lekë (rreth 754,000 EUR) për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile. Fondi pritet të shpallet vitin e ardhshëm. Po në vitin 2019, në kuadër të bashkëpunimit me Partnerët Shqipëri për zbatimin e projektit "CAUSE – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale ", një nismë novatore e financuar nga BE-ja, dy prona të tjera të konfiskuara nga krimi i organizuar (duke shtuar të parën në vitin 2018) iu dhanë OSHC-ve për themelimin e sipërmarrjeve sociale⁴² përmes një kontrate hua-përdorimi me AASPK për një periudhë të paktën 5 vjeçare.

Financimi Publik në Nivel Lokal

Programi për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) është një skemë financimi që mbështet OSHC-të në nivel vendor. Ky program përfshin 12 bashki të Shqipërisë përmes një granti prej 1,130,952 EUR, nga i cili 80% është kontributi i Programit dhe 20% është kontribut nga bashkitë për një periudhë tre vjeçare. Për momentin, janë shpallur tre thirrje publike për projekt propozime që synojnë OSHC-të lokale, veçanërisht organizatat me bazë komunitare që synojnë të forcojnë kapacitetet e organizatave të vogla dhe të reja që veprojnë në 12 bashkitë⁴³. Thirrjet adresonin përparësitë e përcaktuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Sipas informacionit zyrtar, 69 projekt propozime janë përzgjedhur në

³⁹ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Lotarisë Kombëtare [Online] <https://lotaria.al/kreu/ceshtjet-e-mira/viti-2019/>

⁴⁰ Ligji 39/ 2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara" [Online] <http://parlament.al/Files/Akte/20190624141111ligj%20Nr.%2034.%20dt.%2017.6.2019.pdf>

⁴¹ Idem, neni 25


⁴² Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Partneve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim [Online] <http://partnersalbania.org/News/fact-sheets-of-the-social-enterprises-supported-through-c-a-u-s-e-confiscated-assets-used-for-social-experimentation-project/>

⁴³ Ky informacion është marrë nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim [Online] http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/poverty_reduction/regional-local-democracy-programme.html

të dy thirrjet e hapura për projekt propozime, përkatësisht 30 OSHC në thirrjen e parë për projekt propozime dhe 39 OSHC në thirrjen e dytë për projekt propozime.

Siç vërehet në Fig. 4, sikundër edhe në vitet e kaluara, vetëm një numër i kufizuar OSHC-sh (bazuar në intervistat me 152 OSHC) kanë përfituar mbështetje financiare dhe / ose jo-financiare nga institucionet e qeverisë qendrore apo vendore gjatë vitit 2019. Vetëm 21 OSHC nga 152 të intervistuar (13% e OSHC-ve të intervistuarve) kanë marrë fonde nga institucionet e qeverisë qendrore, dhe vetëm 14 prej tyre (9% e OSHC-ve të intervistuarve) kanë përfituar nga fondet e qeverisë vendore. Vetëm 22% e OSHC-ve të intervistuarve kanë përfituar mbështetje jo-financiare.

Figura 4: Format e mbështetjes së shtetit ndaj OJF-ve në vitin 2019



2.2.2. Shpërndarja e fondeve publike


AMSHC-ja ka një rregullore të qartë përmes së cilës kryhet i gjithë procesi i shpalljes së procedurës së dhënies së grantit dhe përzgjedhjes së projekteve që mbështeten. Shpallja për procedurën është publike dhe siguron kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar projekt propozimet dhe të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese. AMSHC-ja publikon paraprakisht kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e projekteve të cilat u vihen në dispozicion publikut që në publikimin e thirrjes për projekt propozime. Gjithashtu, rregullat mbi konfliktin e interesit janë të përshkruara qartë në rregulloren e brendshme të AMSHC-së.⁴⁴

Vetëm 24% e OSHC-ve të intervistuarve pohuan se prioritetet e thirrjeve për projekt propozime përcaktohen me pjesëmarrjen e OSHC-ve, ndërsa 37% e tyre, kryesisht OSHC të vogla dhe me seli jashtë Tiranës, u shprehën se kërkesat e aplikimit nuk janë të lehta për t'u përmbushur.

Nga ana tjetër, transparenca e shpërndarjes së fondeve publike mbetet një pikë e dobët. Vendimet për shpërndarjen e fondeve nuk konsiderohen të drejta nga 47% e OSHC-ve të intervistuarve.

⁴⁴ "Procedurat e Brendshme mbi Financimin e Granteve", AMSHC, Dhjetor 2016 [Online].
<http://www.amshc.gov.al/web/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

Figura 5: Përvoja praktike e OSHC-ve me fondet publike



2.2.3. Përgjegjshmëria, Monitorimi dhe Vlerësimi i Financimit Publik

Dokumentat e vetëm ligjorë të disponueshëm dhe të njohura për OShC-të që rregullojnë përgjegjshmërinë, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve publike janë ato të AMSHC-së. Ligji⁴⁵ dhe Rregullorja e AMSHC-së mbi procedurat e financimit të granteve⁴⁶ kanë rregulla të qarta rreth mënyrës se si do të vlerësohet dhe monitorohet financimi i projekteve dhe janë pjesë shumë e rëndësishme e sistemit / procesit të shpërndarjes. Të gjithë përfituesve të fondeve publike u kërkohet të paraqesin raporte që detajojnë përdorimin e fondeve të marra.

Nga monitorimi i të gjitha faqeve zyrtare online të institucioneve të identifikuara publike që ofrojnë mbështetje financiare për OShC-të, rezultoi se mungojnë raportet e vlerësimit mbi impaktin e fondeve publike të shpërndara tek OShC-të.

Sipas OShC-ve të intervistuar, vetëm 9 OShC nga 43 OShC që kanë përfituar fonde publike kanë qenë subjekt i monitorimit nga autoritetet shtetërore për zbatimin e projektit të financuar përmes këtyre fondeve. Dy (2) prej tyre deklaruan se monitorimi ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara paraprakisht, dhe një (1) u shpreh se kishte marrë njoftim paraprak mbi monitorimin nga nëpunësit shtetëror.

2.2.4. Mbështetja jo-financiare

Nuk ekziston një kuadër ligjor ose rregullor me dispozita specifike që autorizojnë autoritetet shtetërore të ofrojnë mbështetje jo-financiare për OShC-të.

22% e OShC-ve të intervistuar kanë marrë mbështetje jo-financiare nga institucionet publike në formën e ambienteve të ofruara falas për aktivitete ose mbledhje pune, trajnime falas, pajisje, etj. OShC të tjera

⁴⁵ Ligji Nr. 10093, datë 9.3.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)" [Online] http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/LIGJ_Nr._10093_date_9.3.2009.pdf

⁴⁶ Vendim për Miratimin e Rregullores së Brendshme mbi Procedurat e Financimit me Grante, AMSHC [Online] <http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

përmendin partneritetin me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese.

Kutia 3: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

2.4. a. Perceptimi i OShC-ve në sigurimin e fondeve në aspektet e transparencës, paanësisë dhe jo-diskriminimit

- Financimi publik nuk është i mjaftueshëm për mbështetjen e OShC-ve. Bazuar në vëzhgimin me 152 OShC të intervistuar, perceptimi i tyre është se fondet publike nuk iu përgjigjen nevojave të OShC-ve (42% e OShC-ve nuk janë dakort që fondet publike u përgjigjen nevojave të OShC-ve, dhe 21% nuk bien fare dakort).

- Vendimet për shpërndarjen e fondeve nuk konsiderohen të drejta nga 47% e OShC-ve të anketuara.

2.4. c. Cilësia e kuadrit të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile

- Nuk ka një kornizë të unifikuar për të gjithë fondet publike që janë në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile. Prandaj, të gjitha institucionet publike hartojnë dhe zbatojnë kornizën e tyre bazuar në legjislacionin dhe praktikën në fuqi.

- Në lidhje me fondet publike shpërndarë OShC-ve përmes AMSHC-së, ekziston një kuadër rregullues ligjor në dispozicion të publikut me rregulla dhe procedura mbi shpërndarjen dhe menaxhimin e fondit vjetor. Për shkak se ky fond nuk mbështetet nga një strategji afatgjatë dhe e mirë planifikuar, ai nuk ka arritur të adresojë nevojat kryesore të sektorit.

- Bazuar në përvojat e tyre, 37% të OShC-ve të intervistuar, kryesisht OShC-të vogla dhe me seli jashtë Tiranës, pohojnë se procedurat e aplikimit për fondet publike nuk janë të lehta për t'u përmbushur, duke kufizuar mundësinë e tyre për të aplikuar dhe përfituar nga fondet publike.

Nën-fusha 2.3. Burimet Njerëzore

2.3.1. Punësimi në OSHC


Legjislacioni në fuqi nuk stimulon, por as nuk pengon punësimin në OSHC. Kodi i Punës dhe i gjithë legjislacioni përkatës i trajtojnë të gjithë të punësuarit në mënyrë të barabartë, përfshirë të punësuarit nga OSHC-të. Në vitin 2019 u miratua Ligji 15/2019, datë 13.03.2019 "Për Nxitjen e Punësimit"⁴⁷. Zbatimi i tij pritet të rrisë nivelin e punësimit duke ofruar shërbime dhe programe publike për punësim, vetëpunësim dhe kualifikime profesionale.

Neni 21 i Ligjit përcakton krijimin e Fondit Social të Punësimit për punësimin e "grupeve të veçanta".⁴⁸ Ky fond do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe ri-aftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstruksion dhe përshtatje të vendit të punës, programe ri-integrimi social, mbështetje për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara. Do të ngrihet një Bordi i Administrimit të Fondit, cili do të administrojë shpërndarjen e Fondit. Deri më tani, nuk ka asnjë informacion mbi ndarjen e Fondit Social për Punësim.

Sipas informacionit zyrtar të DPT-së janë 9,966 punonjës të punësuar në sektorin jo-fitimprurës. Asnjë informacion nuk u dha në lidhje me punonjësit me kohë të plotë, të punësuarve me kohë të pjesshme dhe numrin e vullnetarëve, edhe pse ky informacion mblidhet nga deklaratat që dorëzojnë OSHC-të.

Bazuar në rezultatet e vëzhgimit, siç pasqyrohet në Fig. 6, pjesa më e madhe e organizatave të intervistuar kanë 0-5 të punësuar me kohë të plotë.

Figura 6: Punonjës me kohë të plotë në OSHC-të e intervistuar




⁴⁷ Ligji 15/2019, date 13.03.2019 "Për nxitjen e punësimit" [Online]

<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190318131036ligj%20Nr.%2015.%20dt.%2013.3.2019.pdf>

⁴⁸ Idem, neni 3

Organizatat që kanë mbi 35 të punësuar me kohë të plotë përfaqësojnë 4% të OShC-ve të intervistuar dhe janë organizata që ofrojnë shërbime sociale në qytete të ndryshme. 89% e OShC-ve të intervistuar kanë 0-5 të punësuar me kohë të pjesshme.

Figura 7: Punonjës me kohë të pjesshme në OSHC-të e intervistuar



2.3.2. Vullnetarizmi në OSHC

Vullnetarët janë një pjesë shumë e rëndësishme e burimeve njerëzore të OSHC-ve. Nuk ka të dhëna për numrin e vullnetarëve të angazhuar në organizatat e shoqërisë civile në vend. Në përputhje me Ligjin për Vullnetarizmin, në vitin 2018 u miratuan dy vendime nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë: Urdhër Nr. 229/2018 "Për Formën dhe Përmbajtjen e Librezës së Vullnetarit"⁴⁹ dhe Urdhër nr. 300/2018 "Për Formën dhe Përmbajtjen e Regjistrit të Kontratave të Vullnetarizmit"⁵⁰. Në korrik 2019, Këshilli i Ministrave miratoi "Kodin e Etikës së Vullnetarit"⁵¹ duke përmbyllur kuadrin ligjor për vullnetarizmin. Për tu përmendur është fakti që këto urdhëra janë aprovuar përmes politikave "me dyer të mbyllura", dhe shumica e OShC-ve nuk janë në dijeni për dy urdhërat e miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.


Shumica e organizatave që morrën pjesë në këtë vëzhgim kanë 0-10 vullnetarë (64%), siç tregohet në Fig. 9. Organizatat që kanë më shumë se 60 vullnetarë janë ato të krijuara dhe përfaqësuara nga individë të rinj në moshë. Këto organizata kryejnë fushata masive ndërgjegjësuese, advokojnë dhe mbrojnë të drejtat e të rinjve, grave dhe fëmijëve.

49 Urdhër Nr. 229, datë 06.11.2018 "Për Formën dhe Përmbajtjen e Librezës së Vullnetarit" miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nuk ka link publik për këtë urdhër.

50 Urdhër Nr. 300, datë 06.11.2018 "Për Formën dhe Përmbajtjen e Regjistrit të Kontratave të Vullnetarizmit miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nuk ka link publik për këtë urdhër.

51 VKM Nr. 506, datë 17.07.2019 "Kodin i Etikës së Vullnetarit" Fletore Zyrtare 105/2019 [Online] <https://qbz.gov.al/share/7z7QPMOjSqagyGJIH8AWw>

Figura 8: Numri i vullnetarëve në OSHC-të e intervistuar



Në lidhje me deklarin e vullnetarëve, 13% e OSHC-ve të intervistuar pohuan se i kanë regjistruar vullnetarët në Zyrën Kombëtare të Punësimit dhe tek Autoritetet Tatimore, por asnjë prej tyre në Shërbimin Kombëtar të Punësimit siç përcaktohet në ligj, pasi regjistri nuk është ende funksional.

Sikundër është cituar edhe në Raportin e MM 2018, OSHC-të përballen me pasiguri dhe kanë mungesë qartësie mbi përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre. Disa nga çështjet e ngritura nga to mbi zbatimin praktik të ligjit të vullnetarizmit janë: sigurimi i vullnetarëve (ka një mungesë informacioni nga OSHC-të mbi shpenzimet që duhet të paguajnë dhe sesi llogariten ato); procedurat e kontraktimit të vullnetarëve, regjistrimi i tyre në regjistrin e vullnetarëve dhe mungesë qartësie rreth kompetencave të institucioneve ligj-zbatuese përgjegjëse për vullnetarët dhe vullnetarizmin.

2.3.3. Edukimi Jo-formal

Në Ligjin 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"⁵² përkufizimi i të nxënimit jo-formal është mësimnxënia që përfshihet në aktivitete të planifikuara dhe jo domosdoshmërisht të zhvilluara si forma mësimore në aspektin e objektivave mësimore, kohës dhe mbështetjes mësimore. Të nxënimit joformal përcaktohet në rregullore të ndryshme ligjore të nxjerra nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të siguruar të nxënimit joformal me grupet e tjera të interesit, përfshirë OSHC-të. Të qenit vullnetar dhe vullnetarizmi janë pjesë e edukatës shoqërore në kurrikulën e programeve edukuese dhe nuk trajtohen gjerësisht, por vetëm si një temë. Në praktikë, OSHC-të janë gjerësisht të përfshira në edukimin jo-formal përmes programeve të ngritjes së kapaciteteve, kurseve dhe shërbimeve profesionale. Mbi 319 OSHC janë të pajisura me licencë dhe ofrojnë shërbime edukuese dhe sociale.⁵³

⁵² Ligji 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional Në Republikën E Shqipërisë [Online] <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj-nr-15-dt-16-2-2017.pdf>

⁵³ "Një vështrim mbi eko-sistemin e sipërmarrjes sociale në Shqipëri", Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019 [Online]

Kutia 4: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

1.2. a. Numri i të punësuarve në OSHC (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme)

Sipas informacionit zyrtar të DPT janë 9, 966 punonjës që punojnë në OSHC. Nuk ka asnjë informacion të ndarë për punonjësit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. 68% e OShC-ve të intervistuar kanë 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe 9% e OShC-ve të intervistuar kanë 0- 5 të punësuar me kohë të pjesshme.

1.2. d. Numri i vullnetarëve në OSHC sipas llojit të OSHC-së / sektorit

Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve. 64% e organizatave të intervistuar kanë 0-10 vullnetarë. Organizatat që krijohen dhe përfaqësohen nga individë të rinj janë kryesisht organizatat që kanë mbi 60 vullnetarë. Këto organizata zhvillojnë fushata masive ndërgjegjësimi, advokojnë dhe mbrojnë të drejtat e të rinjve, grave dhe fëmijëve.

1.2. f. Cilësia e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor për vullnetarizmin nuk është stimulues për OShC-të që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetare, duke u përballur me vështirësi dhe pasiguri në përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj tyre rrezikut të gjobave.

Fusha 3: Marrëdhënia Shtet-OSHC

Nën-fusha 3.1. Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

3.1.1. Politikat shtetërore dhe strategjitë për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile

Në korrik të vitit 2019, Qeveria Shqiptare miratoi Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile 2019-2023. Dokumenti pasqyron një version të rishikuar të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës 2015 – 2018, të cilit i mungoi zbatimi i duhur. Shumë masa të Udhërrëfyesit 2015 – 2018 nuk u zbatuan. Sipas një raporti të AMSHC-së, vetëm 4 nga 53 masa u zbatuan⁵⁴.

Udhërrëfyesi i rishikuar paraqet një sërë veprimesh dhe masash konkrete në një larmi fushash dhe politikash të ndërlidhura që plotësojnë njëra-tjetrën: kuadrin ligjor me fokus përmirësimin e çështjes së regjistrimit, një kuadër më të fortë institucional për punën e OSHC-ve, mekanizma publikë më të qartë dhe më transparentë për programet e OSHC-ve, gjithë-përfshirje të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe lokal sipas standardeve, konsultime të rregulluara me OSHC-të në hartimin e ligjeve të reja, një politikë të favorshme tatimore dhe një kuadër më të favorshëm ligjor, fiskal dhe institucional për nxitjen e vullnetarizmit dhe për mundësimin e nxitjes së filantropisë.

Janë identifikuar tre fusha strategjike me një paketë prej 42 masash që duhet të ndërmerren nga institucionet e përcaktuara për të krijuar dhe për të ruajtur një mjedis më të favorshëm për shoqërinë civile. Për të garantuar monitorimin e duhur të procesit të zbatimit, janë vendosur 130 tregues për 42 masat e parashikuara.

Bazuar në Udhërrëfyesin 2019-2023, OSHC-të do të përfshihen në procesin e monitorimit duke dhënë opinionet dhe kontributet e tyre në monitorimin e masave të përcaktuara në të. AMSHC-ja, përmes faqes zyrtare të saj do të jetë autoriteti përgjegjës për krijimin e mekanizmave mbi mbledhjen e pikëpamjeve të OSHC-ve. Gjatë vitit 2019, nuk pati njoftime online nga AMSHC-ja në lidhje me këtë monitorim.

Shumica e OShC-ve (68% e OShC-ve të intervistuar) janë të vetëdijshme për ekzistencën e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile, 30% e tyre janë në dijeni të përmbajtjes dhe masave të Udhërrëfyesit, ndërsa 38% e OShC-ve të intervistuar nuk kanë informacion mbi përmbajtjen e tij. 78% e OShC-ve të intervistuar nuk kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuar në kuadër të Udhërrëfyesit 2019-2023. Arsyet e dhëna janë mungesa e besimit se mendimi i OSHC-ve do të merret në konsideratë, mungesa e informacionit për kryerjen e konsultimeve publike mbi Udhërrëfyesin, mungesa e interesit nga vetë OShC-të për t'u angazhuar në të, si dhe mungesa e informacionit se ekziston një dokument i tillë. Bazuar në informacionin e marrë nga AMSHC-ja, 4 takime rajonale u organizuan me OShC-të dhe 20 OSHC ofruan kontributin e tyre mbi Udhërrëfyesin e rishikuar.

3.1.2. Institucionet dhe mekanizmat për zhvillimin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile

Referuar strukturave dhe mekanizmave për dialog dhe bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe institucioneve publike, dy janë mekanizmat kryesorë: Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është një organ konsultativ kolegjal që synon të garantojë bashkëpunimin institucional midis Shtetit dhe OShC-ve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë

⁵⁴ Informacioni është marrë nga fqaja zyrtare e internetit të AMSHC-se [Online] <https://drive.google.com/file/d/1yG-BnN2eldotN186tdunYG86XCem30IN/view>

me pjesëmarrje dhe rritjes së transparencës në vendim-marrjen publike nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces. Në përputhje me Ligjin "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"⁵⁵ Këshilli përbëhet nga 27 anëtarë, 13 përfaqësues nga institucione qeveritare, 13 përfaqësues nga OSHC-të dhe 1 përfaqësues nga Këshilli Kombëtar Ekonomik. Në shtator të vitit 2019, KKSHC përzgjedhi katër anëtarë të rinj nga shoqëria civile duke zëvendësuar ata të cilëve u mbaroi mandati.⁵⁶

Procesi i përzgjedhjes u krye në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile⁵⁷, përmes votimit në internet. AMSHC-ja që vepron si sekretariat nxorri thirrjen për nominime, duke ftuar OShC-të të paraqesin propozimet e tyre për anëtarët e KKSHC. Rezultatet u publikuan në faqen zyrtare të internetit të AMSHC-së.

Gjatë vitit 2019, KKSHC-ja vështirë se ka zhvilluar ndonjë diskutim produktiv për të shprehur prioritetet e OShC-ve në proceset e hartimit të politikave. Sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të AMSHC-së, gjatë vitit 2019 KKSHC-ja organizoi vetëm një mbledhje, ndërsa vendimet e mbledhjes nuk janë ende publike.

Sikundër edhe në raportin e mëparshëm të MM 2018, Ligji për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile duhet të ndryshojë me qëllim që të realizohet përfaqësimi i duhur nga linjat e ministrisë (ndryshimet në portofolet ministrore) dhe numri i përfaqësuesve nga secila ministri (zvogëlimi i numrit të portofoleve ministrore) në mënyrë që të plotësohet balanca e kërkuar e përfaqësimit.

Një strukturë tjetër e rëndësishme, në kuadrin e aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE)⁵⁸. KKIE është një organ këshillimor, i krijuar nga Parlamenti, që synon të promovojë dhe garantojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës midis forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, dhe të rrisë transparencën në vendimmarrjen për çështjet e integritetit. Sipas rregullores të saj të brendshme shoqëria civile përfaqësohet nga tre anëtarë, një numër që u rrit në 8 në 2018. Ndryshimet në numër nuk u mbështetën nga ndryshimet përkatëse në rregullore. Sipas Raportit Vjetor të vitit 2019 të KKIE, Këshilli ka shpallur dy thirrje për aplikime për anëtarësim nga OSHC-të, më 16 prill 2018 dhe më 24 prill 2019. Procesi i zgjedhjeve dhe rinovimit të anëtarëve nga organizatat e shoqërisë civile përfundoi në shtator 2019. Bazuar në raportin vjetor të KKIE, numri i përfaqësuesve të OSHC-ve u rrit në 15 anëtarë⁵⁹. Nga ana tjetër, ekziston nevoja për të rritur vizibilitetin e Këshillit, pasi puna e tij nuk është e promovuar dhe e njohur në sektor.

Nga OSHC-të e intervistuar, rreth gjysma e tyre (58%) deklaruan se janë të informuara për punën e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, siç tregohet në Fig. 9.

Figura 9: Informacioni i OSHC-ve të intervistuar ndaj punës së KKSHC-së

⁵⁵Ligji Nr.119/2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" Fletore Zyrtare 200/2015 [Online] <https://qbz.gov.al/share/q9X3GXAjROi2QTN3otTFAA>

⁵⁶https://drive.google.com/file/d/189rmOpJqXmngD7UrTpdA9N-oysG1pnK0/view?usp=drive_ëeb

⁵⁷Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e AMSHC-së [Online]

<https://drive.google.com/file/d/1xOY3QQRybRIK0EVimImS8loJH6ab00XJ/view>


⁵⁸Ligji Nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" [online]

https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf

⁵⁹"Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian", Këshilli Kombëtar i Integritetit 2020 [Online]

<http://parlament.al/Files/Integrimi/Raporti%20vjetor%20i%20KKIE%202019.pdf>

Informacioni i OShC-ve të intervistuar ndaj punës së KKSHC-së



Të pyetur mbi nivelin e dakortësisë me pretendimin e mëposhtëm: "Vendimet e KKSHC bazohen në rekomandimet dhe kontributin e OShC-ve", 45% e OShC-ve të intervistuar u përgjigjën se nuk janë në dijeni, ndërsa 30% e tyre nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord.

Një rekomandim nga OShC-të e intervistuar për anëtarët e Këshillit të zgjedhur, të cilët përfaqësojnë shoqërinë civile është të rrisin ndërveprimet e tyre me OShC të tjera që ata përfaqësojnë, për të pasur një përfaqësim më të mirë të zërit të OShC-ve brenda Këshillit.

Kutia 5: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

3.1. b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave për dialog dhe bashkëpunim midis OShC-ve dhe institucioneve publike për sa i përket: - Përfaqësimit të OShC-ve në përgjithësi, - përfaqësimit të OShC-ve më të vogla / të dobëta, - vizibilitetit dhe dispozicionit, - perceptimit të qeverisë për cilësinë e strukturave dhe mekanizmave, - Perceptimit të OShC-ve mbi strukturat dhe mekanizmat;

- Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile 2019 – 2023, i rishikuar u miratua në korrik 2019, duke përfshirë tregues konkretë për të matur zbatimin e tij si dhe buxhet.

- Ekziston një perceptim jo pozitiv i OShC-ve mbi efektivitetin e Udhërrëfyesit, reflektuar në një përqindje të lartë të OShC-ve të intervistuar (78%) që nuk marrën pjesë në konsultimet për përgatitjen e dokumentit të rishikuar. Ndër arsyet kryesore të shprehura janë mungesa e besimit se mendimet e tyre do të konsiderohen dhe mungesa e interesit për t'u përfshirë në këtë proces.

- Asnjë nismë ligjore nuk është ndërmarrë për të ndryshuar Ligjin për Krijimin dhe Funkcionimin e KKShC me qëllim që të realizohet përfaqësimi i duhur nga linjat e ministrisë (ndryshimet në portofolet ministrore) dhe numri i përfaqësuesve nga secila ministri (zvogëlimi i numrit të portofoleve ministrore) në mënyrë që të plotësohet balanca e kërkuar e përfaqësimit.

- KKShC nuk ka arritur të dëshmojë veten si një organ këshillimor kolegjal për bashkëpunim institucional ndërmjet Shtetit dhe OShC-ve. Performanca e KKSHC deri më tani ka qenë e dobët veçanërisht në diskutime, në adresimin e prioritetëve kryesore të sektorit të OSHC-ve në lidhje me mjedisin mundësues dhe pjesëmarrjen në proceset e hartimit të politikave. Asnjë informacion mbi vendimet e marra nga Këshilli në vitin 2019 nuk është publikuar, në kuadrin e punës së tij për mbështetjen e shoqërisë civile.

Nën-fusha 3.2. Përfshirja në procesin e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes


3.2.1. Standardet për përfshirjen e OShC-ve

Kuadri ligjor mbi përfshirjen e OShC-ve në politikë-bërje dhe vendimmarrje nuk ndryshoi në vitin 2019. Ligji 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" parashtron kërkesa mbi konsultimet për projektligjet dhe politikat. Ai parashikon kohë të mjaftueshme për tu njohur me dokumentet dhe për të dërguar një propozim. Gjithashtu, ai detyron autoritetet publike të dërgojnë përgjigje me shkrim në lidhje me propozimet e marra me shpjegime pse disa prej tyre nuk janë pranuar.

Bazuar në vendimin Nr. 61/2018, datë 05.04.2018 "Për miratimin e Kodit të Etikës për Anëtarët e Parlamentit të Shqipërisë", është krijuar regjistri elektronik i lobistëve⁶⁰. Sipas nenit 22, deputetët regjistrojnë çdo takim me palët e jashtme si një masë për të kontrolluar çdo konflikt interesi mbi përpjekjet e lobimit nga grupet e interesit. Në lidhje me këtë, çdo OSHC që dëshiron të ushtrojë të drejtën e pjesëmarrjes dhe të shprehë mendimet e saj mund të paraqesë kërkesën e saj në Parlament dhe të bëhet anëtar i regjistrit të lobistëve. Sipas informacionit zyrtar të vënë në dispozicion, 54 anëtarë nga OSHC-të janë regjistruar në këtë regjistrë⁶¹. Rregullores në fuqi i mungon një përcaktim i qartë i termit "lobist" dhe mënyra si rregullohet kjo veprimtari.

Përafërsisht më shumë se gjysma e OSHC-ve të intervistuar (59%) kanë qenë të përfshira në konsultime për përgatitjen e projektligjeve dhe politikave, ndërsa 37% e OSHC-ve deklaruan se nuk kanë marrë pjesë në asnjë proces, siç tregohet në Fig. 10. Nga përgjigjet e OSHC-ve të intervistuar vërehet se shumica e tyre kanë marrë pjesë në konsultime të bëra në nivel vendor nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Për tu përmendur janë pjesëmarrja e OShC-ve në proceset e konsultimeve mbi paketën fiskale dhe buxhetimin vjetor vendor, konsultimet për shërbimet sociale në nivelin vendor, strategjia e të rinjve në nivelin vendor, etj.

Graph 10: Pjesëmarrja e OSHC-ve në Konsultimet Publike



Të pyetur për arsyet e mos marrjes pjesë në konsultimet publike, OShC-të e intervistuar përmendin


⁶⁰ Vendimi Nr. 61/2018, datë 05.04.2018 "Për miratimin e Kodit të Etikës për Anëtarët e Parlamentit të Shqipërisë", u krijua një regjistrë elektronik i lobistëve <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>

⁶¹ Informacioni është marrë nga Parlamenti shqiptar [Online] <https://www.parlament.al/Files/Informacione/lobistet.xlsx>

mungesën e besimit që konsultimet dhe kontributet e ofruara nga OShC-të do të merren seriozisht në konsideratë nga institucionet publike; mungesa e njoftimit dhe informacionit mbi konsultimet publike; kohë e kufizuar për të dhënë përgjigje; fushat e konsultimit nuk kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së OShC-ve, etj.

Përsa i përket vlerësimit të disa aspekteve të pjesëmarrjes së OShC-ve në proceset e konsultimit, vihet re një vlerësim pozitiv nga OShC-të mbi aftësitë e nëpunësve civilë për të përfshirë OShC-të në konsultime, dhe aftësitë e tyre për të lehtësuar angazhimin e tyre në proceset e konsultimit. Respektivisht, 35% e OSHC-ve të intervistuarra bien dakord se nëpunësit civilë kanë kapacitetet e duhura për të përfshirë OSHC-të në procesin e konsultimit, dhe 40% e OShC-ve bien dakord se nëpunësit civilë lehtësojnë angazhimin efektiv të OShC-ve gjatë procesit të konsultimit. Është vlerësuar gjithashtu pozitivisht koha e vendosur në dispozicion për të përgatitur dhe dorëzuar komente, me 46% të OShC-ve të intervistuarra që bien dakord se OSHC-të kanë kohë të mjaftueshme në dispozicion. Nga ana tjetër, ekziston një ndarje pothuajse e barabartë midis OShC-ve që bien dakord se organizatat e shoqërisë civile kanë informacionin e duhur përpara procesit të konsultimit (36% e OShC-ve të intervistuarra), me ato që nuk bien dakord ose nuk janë fare dakord me këtë pohim (31% nuk janë dakord dhe 7% nuk janë fare dakord).

Graph 11: Pjesëmarrja e OSHC-ve në konsultimet publike



Në lidhje me rezultatin të proceseve të konsultimit, pothuajse gjysma e OShC-ve të intervistuarra (45%) u shprehen se disa nga sugjerimet dhe rekomandimet e tyre janë marrë parasysh nga autoritetet publike që organizojnë procesin e konsultimit.

3.2.2. Aksesi i publikut në projektligjet dhe ligjet

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik detyron institucionet publike të bëjnë publike të gjitha projektligjet dhe ligjet e miratuara, ndërsa përjashtimet përcaktohen qartë dhe janë në përputhje me normat ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë. Ligji garanton kohë të mjaftueshme deri në 20 ditë që qytetarët dhe grupet e interesit të japin mendimin dhe komentet e tyre mbi projektligjet dhe politikën. Gjithashtu, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 07.10.2015 për "Për Miratimin e


Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik", është krijuar një regjistër elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Një tjetër ligj i rëndësishëm që mundëson aksesin në informacion është Ligji Nr. 114/2014 Për të Drejtën e Informimit. Sipas këtij ligji, autoritetet publike janë të detyruara të publikojnë informacione në faqen e tyre zyrtare të internetit pa pasur nevojë që qytetarët të dërgojnë kërkesa për informacion tek autoritetet publike. Ata duhet të publikojnë Programin e Transparencës dhe të emërojnë një koordinator për të drejtën e informimit.

Për të dokumentuar zbatimin e detyrimit për të drejtën e informimit nga institucionet shtetërore, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa për informacion tek të gjitha ministritë dhe institucioneve të tjera publike. Vetëm tre ministri, (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) iu përgjigjën kërkesës. Këtë vit edhe Parlamenti nuk arriti të sigurojë informacione mbi proceset e tyre konsultative.

Nga OShC-ve e intervistuar, 46% e tyre kanë dërguar kërkesa për informacion pranë institucioneve publike. Niveli i përgjigjeve të institucioneve publike ndaj kërkesës së tyre u vlerësua pozitivisht, pasi 86% e OShC-ve të intervistuar u shprehën për marrjen e përgjigjeve ndaj kërkesave të dërguara. Përgjigja e marrë u dha në format të qarta (70% të OShC-ve) dhe u dërgua brenda 10 ditëve siç përcaktohet në Ligjin 14/2014 Për të Drejtën e Informimit (69% e OShC-ve). Ka ende nevojë për përmirësime në lidhje me dhënien e sqarimeve kur kërkesa për informacion refuzohet. 72% e OShC-ve deklaruan se kërkesa e tyre ishte refuzuar pa ndonjë shpjegim.

Tabela 12: Përvoja praktike e OSHC-ve mbi kërkesat për informacion



Nga raporti vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2019⁶², Zyra e Komisionerit mori 786 ankesa. Një prirje pozitive ishte rritja e numrit të ankesave nga ana e OSHC-ve krahasuar me palët e tjera të interesit, si një tregues i ndërgjegjësimit të tyre për

⁶² "Raporti Vjetor 2019", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019 [Online] https://ëëë.idp.al/ëp-content/uploads/2020/03/Annual_Report_2019.pdf

ushtrimin e së drejtës për informacion. Nga ana tjetër, sipas një raporti për të drejtën e informimit, të përgatitur nga ResPublika⁶³, në vitin 2019 u vu re një regres në punën e Komisionerit bazuar në numrin e ulët të vendimeve të tij, numrin shumë të ulët të masave administrative të marra duke marrë konsideratë nivelin e ulët të transparencës së institucioneve, etj.

Në nivel vendor, duke iu referuar një raporti monitorimi mbi transparencën e qeverisjes vendore në Shqipëri⁶⁴ përgatitur nga BIRN, vërehet një përkeqësim i lehtë mbi transparencën pro aktive në faqet zyrtare të internetit dhe ambientet fizike të bashkive krahasuar me të njëjtin monitorim të vitit 2017. Një program i ri transparence i përgatitur nga të gjitha bashkitë i cili do të mundësonte publikimin e të gjitha dokumenteve publike që janë pa pagesë, dhe publikimi i të gjitha njoftimeve për konsultime publike në portalin <http://www.konsultimipublik.gov.al/>, janë ndër rekomandimet e dhëna në raport për të rritur transparencën dhe konsultimet publike në nivel vendor.

3.2.3. Përfaqësimi i OShC-ve në strukturat ndër-sektoriale

Një indikator tjetër matës i përfshirjes efektive të OShC-ve në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes është pjesëmarrja e tyre në organet ndër-sektoriale. Shqipëria nuk ka një kuadër ligjor specifik që rregullon përfshirjen e OShC-ve në këto struktura. Një instrument i rëndësishëm në këtë drejtim është Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018–2020 (PKIE), i aprovuar nga Qeveria e Shqipërisë në Maj të 2018-ës, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 246, të datës 9.05.2018.65. Ky instrument shërben si një mjet i planifikimit afatshkurtër dhe afatmesëm i masave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe procesi i integritimit në mënyrë që të arrihet përafrimi i plotë ligjor i legjisllacionit kombëtar me atë të BE-së. Shoqëria civile njihet si një aktor i rëndësishëm në përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi aprovimin e PKIE-s, një urdhër i miratuar nga Kryeministri hyri në fuqi për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit të integritimit evropian⁶⁶. Sipas këtij urdhri, organizatat e shoqërisë civile janë partnerë të rëndësishëm në të dy nivelet e përfaqësimit sipas të cilës platforma është organizuar: (i) Bordi Drejtues që përbëhet nga 15 anëtarë, dy prej të cilëve vijnë nga organizatat e shoqërisë civile, dhe 33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e "acqui" të Bashkimit Evropian. Anëtarësia është e hapur për të gjithë, dhe në bazë të procedurës palët e interesuara duhet të paraqesin një letër interesi dhe një CV personale ose një CV të entitetit që përfaqësojnë. Vlerësimi i aplikimeve bëhet nga anëtarët e Grupeve të Punës.

Shumë pak është bërë përgjatë vitit 2019 në lidhje me zbatimin e PKIE dhe krijimin e strukturës së saj institucionale. Ka 14 institucione publike përgjegjëse për udhëheqjen e procesit të konsultimit, dhe gjatë vitit 2019, vetëm Ministria e Drejtësisë ka arritur të organizojë tryeza diskutimesh dhe konsultimesh me pjesëmarrjen e OShC-ve, ndërsa ministrinë e tjera kanë shpallur thirrje publike për ftesë për pjesëmarrje në këto tryeza. Prosesi i aplikimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve në tryezat e diskutimit dhe konsultimit është parashikuar në urdhrin e Kryeministrit, por në praktikë kriteret e aplikimit dhe të përzgjedhjes janë të paqarta dhe jo transparente.

Prej OShC-ve që morën pjesë në këtë vëzhgim, 34% e tyre ka marrë pjesë në grupe këshillimore apo


⁶³ <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2020/02/E-drejta-e-informimit-2019-Res-Publica-web-min-compressed.pdf> ⁶⁴ "Pushteti vendor nën lanten e së drejtës për informim", BIRN 2019 [Online] <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2019/05/Pushteti-vendor-single-page-web-1.pdf>

⁶⁵ VKM Nr 246 of 9.05.2018 "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian" (PKIE) 2018 – 2020" [Online] <https://punetjashme.gov.al/ep-content/uploads/2018/10/vkm-nr-246-date-9-5-2018-2-plani-kombetar-per-integrimin-evropian-2018-2020.pdf>

⁶⁶ <https://drejtësia.gov.al/ep-content/uploads/2019/10/Urdhri-i-Kryeministrit-Nr.113-dat%C3%AB-30.08.2019.pdf>

grupe pune sikundër reflektohet në Fig. 13.

Figura 13: Pjesëmarrja e OSHC-ve në grupe pune/ këshillimore



Kryesisht këto janë struktura këshillimore dhe konsultative, si Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore, Grupet e Punës për Reformën në Arsimit dhe për Ligjin e Rinisë, etj.

63% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se procedurat e përzgjedhjes së OSHC-të në këto grupe këshilluese dhe komitete pune ishin publike dhe transparente.

Pyetjes nëse ata mund të shprehnin lirshëm qëndrime kritike në organet e grupeve këshillimore, konsultative apo grupet e punës, 80% e OSHC-ve të intervistuar që janë pjesë anëtarë të këtyre strukturave pohuan se ndihen të lirë të shprehin mendimin e tyre.

Kutia 6: Vlerësimi i Udhëzimeve të BE-së

3.1.a. Përqindja e ligjeve / akteve nënligjore, strategjive dhe reformave politike të konsultuara në mënyrë efektive me OShC-të në drejtim të: - aksesit adekuat në informacion; - kohës e mjaftueshme për të komentuar; - përzgjedhjes dhe përfaqësimit / diversitetit të grupeve të punës; - njohjes së informacionit; - shkallës në të cilën merret parasysh inputi; - feedback-u / publikimi i rezultateve të konsultimit.

- Nuk ka informacion në dispozicion të publikut mbi përqindjen e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive dhe reformave politike të konsultuara në mënyrë efektive me OShC-të.

- Bazuar në vëzhgimin e OShC-ve, vihet një reagim i lartë i institucioneve shtetërore ndaj kërkesave për informacion të OShC-ve (86% e OShC-ve të intervistuar deklarojnë se kërkesa e tyre për informacion mori përgjigje). Ende mungon sqarimi nga autoritetet publike kur një kërkesë për informacion nuk merr përgjigje, sikundër deklarohet nga 72% e OShC-ve të intervistuar.

- Një nga shqetësimet kryesore të OShC-ve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në konsultime publike mbetet mungesa e besimit që komentet / informacioni i dhënë prej tyre do të merren në konsideratë nga institucionet publike.

Nën-fusha 3.3. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

3.3.1. Angazhimi i OShC-ve në Ofrimin e Shërbimeve dhe Konkurrenca për Kontratat Shtetërore

OShC-të janë aktorët kryesorë që ofrojnë shërbime sociale për një gamë të gjerë përfituesish. Gjatë vitit 2019, nuk pati nisma ligjore apo diskutime mbi ligjin për prokurimin publik. Kuadri ligjor aktual paraqet shumë sfida dhe çështje që duhen adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike. Rregullat e tenderimit janë të unifikuara dhe zbatohen në mënyrë të barabartë si për OShC-të, ashtu edhe për subjektet e tjera private ofertuese. Kriteri kryesor për fitimin në prokurimin publik është çmimi më i ulët i ofruar duke shpërfillur cilësinë e shërbimit. Përveç kësaj, shpenzimet e lidhura me tenderimin (d.m.th. fondi i garancisë, rimbursimi i shpenzimeve kundrejt parapagimit, skema jo e qartë dhe e rregullt e pagesave) paraqesin një pengesë serioze për pjesëmarrjen e OShC-ve në çdo procedurë tenderimi.⁶⁷

Për sa i përket ndërmarrjeve sociale, asnjë nismë ligjore nuk u ndërmor gjatë 2019. Sikundër citohet edhe në raportet e mëparshme të MM, paketa ligjore për ndërmarrjet sociale konsiderohet shumë problematike sepse i trajton ndërmarrjet sociale si ndërmarrje shtetërore, kufizon shumë mundësitë e NS-ve për të pasur akses në fonde jo-publike dhe minimizon hapësirat e produktivitetit të tyre si regjimi fiskal është shumë kufizues.

OShC-të kanë rritur ndikimin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe sipas të dhënave nga Shërbimi Social Shtetëror ka 165 ofrues të shërbimeve jo-publike (66%), dhe 86 ofrues të shërbimeve publike (34%), të ndara me bazë Qarku. Shumica e ofruesve të shërbimeve jo-publike janë organizata të shoqërisë civile.

3.3.2. Financimet shtetërore për shërbimet e ofruara nga OSHC-të

Vendimi Nr. 789/2018 "Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale dhe Format e Mbështetjes Nëpërmjet Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale" vendos krijimin e një fondi me vlerë të përgjithshme 249 760 000 (afërsisht 2,000,000 EUR). Ky fond do të shpërndahet për periudhën 2019-2021 për OShC-të që kanë marrë statusin e ndërmarrjes sociale nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Fondi parashikon tre forma të subvencionit:

1. veprimtaria e ndërmarrjeve sociale - Fondi mbulon deri në 70% të kostove të pranueshme, por jo më shumë se 1.500,000 lekë (afërsisht 12,000 EUR).
2. vendet e reja të punës të krijuara për punësimin e individëve nga grupet e pafavorizuara - Për çdo vend pune të krijuar, ndërmarrjet sociale mund të përfitojnë deri në 100,000 lekë (afërsisht 800 EUR), të cilat duhet të përdoren për mjetet e punës, lëndët e para dhe material të konsumueshme. Subvencioni kushtëzohet nga punësimi i individëve nga grupe të pa-favorizuara me kohëzgjatje kontrate jo më pak se dy vite.
3. Sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pa-favorizuara. Ndërmarrjet sociale mund të marrin fonde vjetore deri në 100% të shumës të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të jetë jo më pak se dy vite.

Fondi nuk është shpallur ende.

⁶⁷ [Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligji Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligji Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligji Nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligji Nr. 22/2012, Ligji Nr. 131/2012 and Ligji Nr. 182/2014 "Për Prokurimin Publik"](#)

VKM Nr. 111, datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social"⁶⁸, parashikon krijimin e një mekanizmi financiar që do të sigurojë mbështetje financiare për Njësitë e Vetë-qeverisjes Vendore me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administrative të shërbimeve ekzistuese të kujdesit social, planifikimit dhe krijimit të shërbimeve të reja. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të menaxhojë këtë fond dhe do të financojë në masën 90% projektet e paraqitura në vitin e parë, 60% në vitin e dytë dhe 30% në vitin e tretë. Në vitin 2019, Ministria financoi 14 shërbime sociale të reja në 14 Bashki⁶⁹. Nuk ka informacion publik mbi financimin e shpërndarë.

Në nivel vendor, Bashkia e Tiranës përmes Programit të saj të Kujdesit Social dhe Solidaritetit synon të përmirësojë standardet e ofrimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit social, planifikimin e shërbimeve të reja sociale, si dhe zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor.

Ky program përfshin gjithashtu Fondin Social i cili do të mbështesë zbatimin e projekteve që kanë në fokus fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta, të moshuarit në nevojë, fuqizimin social dhe stabilitetin ekonomik të grave kryefamiljare dhe grave në nevojë ekonomike përmes zgjerimit të rrjetit të shërbimeve sociale të ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë.

Nën këtë program, në Tetor 2019, Bashkia shpalli një thirrje për projekt propozime që targetonte OShC-të që ofrojnë shërbime sociale.⁷⁰ Qëllimi i përgjithshëm i thirrjes ishte përmirësimi i cilësisë të jetës së kategorive dhe grupeve në nevojë. Buxheti i përgjithshëm në dispozicion ishte 24,000,000 lekë (përafërsisht 190,000 EUR) për një periudhë 12 mujore. Asnjë informacion nuk është publik mbi përzgjedhjen e fituesve.

Ekzistojnë tre (3) OSHC, pjesë e këtij vëzhgimi, të cilat pohuan se kanë përfituar grante për mbështetje institucionale përmes skemës së subvencioneve të buxhetuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të shpërndarë nga institucioni i Qarkut. Skema synon OShC-të që ofrojnë shërbime sociale për grupe të pa-favorizuara, gra dhe vajza viktime të trafikimit dhe dhunës në familje, etj. Skema mbulon pagat e punonjësve në nivelin 100%.

3.3.3. Procedurat për shërbimet kontraktuale

Ligji për prokurimin publik nuk diskriminon asnjë subjekt juridik privat që kërkon të aplikojë. Përzgjedhjet bazohen mbi çmimin më të ulët dhe ofertat ekonomike. Subjektet kanë mundësinë që të apelojnë vendimin brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit për refuzim. OSHC-të janë persona juridikë që kanë të drejtë të marrin pjesë në tenderat publik.

Në praktikë, procedurat për shërbimet kontraktuale bëhen përmes skemës konkurruese të granteve dhe jo përmes procedurës së prokurimit publik. Asnjë nga OSHC e intervistuar si pjesë e këtij vëzhgimi nuk ka marrë pjesë në procedura tenderimi.

3.3.4. Përgjegjshmëria, Monitorimi dhe Vlerësimi i Ofrimit të Shërbimit

Autoritetet publike që kontraktjnë shërbime përmes OShC-ve, kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll dhe të monitorojnë cilësinë e shërbimeve dhe fondet. Ata kanë të drejtë të inspektojnë ambientet në të cilat ofrohen shërbimet, duke njoftuar paraprakisht. Pas procesit të inspektimit, autoriteti inspektues duhet të përgatisë një raport inspektimi dhe ta ndajë atë me ofruesin e shërbimit, duke përfshirë rekomandime për

⁶⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 111, datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social", Fletorja Zyrtare 27/2018 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/27/adbe8f12-3962-4c64-a24d-2385c14d917f>

⁶⁹ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare [Online] <https://ata.gov.al/2019/11/22/fondi-social-financohen-14-sherbime-te-reja-ne-14-bashki/>


⁷⁰ Informacioni është marrë nga faqja zyrtare e internetit të Bashkisë së Tiranës [Online] <https://tirana.al/artikull/thirrje-publike-per-organizatat-e-shoqerise-civile-per-dorezimin-e-projekt-propozimeve-ne-programin-kujdesi-social-dhe-solidariteti>

përmirësime të identifikuar gjatë inspektimit.

OSHC-të e anketuara nuk kanë ndonjë vlerësim lidhur me rolin monitorues të institucioneve shtetërore në rastet e kontraktimit të shërbimeve. Kjo është për shkak të mungesës së praktikës nga OSHC-të pjesëmarrëse në anketim.

Sipas OShC-ve të anketuara, ka mungesë informacioni për prokurimet publike, veçanërisht në lidhje me drejtësinë dhe shpërndarjen transparente të kontratave shtetërore (55% të OSHC-ve të anketuara), përjashtimin e OSHC-ve nga thirrjet për tenderime për shkak të fushës së tyre të punës (47% e OShC-ve të anketuara) dhe kapacitetet e nëpunësve shtetërorë për të zbatuar procedurat për shërbimet e kontraktuara (45% të OSHC-ve të anketuara). Për më tepër, 27% e OShC-ve të anketuara vlerësojnë se fusha e tyre e shërbimeve nuk përfshihet në thirrjet aktuale për tenderime.

Figura 14: Vlerësimi i pohimeve mbi pjesëmarrjen e OSHC-ve në prokurimin publik



Konkluzione dhe Rekomandime

Përsa i përket **Garancive Themelore Juridike të Lirive**, vihet re një tendencë në rritje e kontrollit të shtetit mbi veprimtarinë e OShC-ve dhe ndërhyrje në pavarësinë e tyre, përmes përgatitjes dhe miratimit të disa ligjeve dhe rregulloreve. Mund të përmendim: - miratimin i Ligjit të ri për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, i cili paraqet kërkesa të reja raportimi për OShC-të nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare është mbi vlerën 30 milionë lekë (afërsisht 235,000 EUR). Sipas ligjit, këto OSHC duhet të përgatitin dhe publikojnë një raport performance në lidhje me veprimtarinë e tyre. Edhe pse zyrtarisht nuk është miratuar, formati i këtij raporti rrit kërkesat raportuese nga ana e shtetit dhe pritet të përfshijë kërkesa për informacione që tashme sigurohen nga OSHC-të përmes raporteve të tjera që dorëzohen tek autoritetet publike. Gjithashtu, ky raport do të lejojë për një vlerësim të punës së këtyre OSHC-ve nga ana e shtetit. Ndërsa kjo është një kërkesë normale për OSHC-të që përfitojnë fonde publike apo mbështetje të tjera nga shteti, në këtë rast nuk justifikohet dhe krijon hapësira për ndërhyrje të shtetit në veprimtarinë e OSHC-ve të cilat nuk përfitojnë fonde publike – Paketa ligjore kundër pastrimit të parasë dhe luftën kundër terrorizmit dhe aktet nënligjore prezantojnë një set indikatorësh risku për të matur aktivitetin e OSHC-ve. Plotësimi i kuadrit ligjor që përcakton kriteret e riskut nuk është shoqëruar me një fushatë ndërgjegjësuese dhe edukuese për OSHC-të mbi këto kriteret dhe masa që OSHC-të duhet të marrin. Si rrjedhojë, nuk ka një kuptueshmëri të pranuar gjerësisht sesi ndërhyrja e qeverisë kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (AMF/CTF) mund të ndikojë tek një numër organizatash dhe tek sfidat që sektori po has si rezultat i përpjekjeve kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. – Ligji Për Rininë parashikon krijimin e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, dhe kriteret që duhet të përmbushë për t'u njohur nga institucionet publike përgjegjëse për rininë aprovohen përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave. Kjo konsiderohet dhunim i pavarësisë së OSHC-ve nga shteti, dhe është në kundërshtim jo vetëm me ligjin për organizatat jo-fitimprurëse, por edhe me Kodin Civil dhe të drejtën e organizimit si një e drejtë Kushtetuese. (neni 13). Ligji parashikon gjithashtu një fond publik nga buxheti i shtetit për grante dedikuar të rinjve që do të përdoret për mbështetje të projekteve rinore dhe projekteve të organizatave rinore. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes përcaktohet përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave. Kjo është një tjetër çështje shqetësuese që forcon varësinë e organizatave rinore nga qeveria, duke i kthyer ato në GONGO (një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar dhe financuar nga qeveria, për të përmbushur qëllimet dhe interesat politikë).

Nga ana tjetër, asgjë nuk është bërë për të adresuar shqetësimin dhe rekomandimin afatgjatë të OShC-ve për decentralizimin e procesit të regjistrimit, si dhe përgatitjen dhe publikimin e një regjistri elektronik të OSHC-ve, të cilat gjithashtu përfshihen si çështje prioritare në Udhërrëfyesin për Shoqërinë Civile (i vjetër dhe të ri).

Një tjetër zhvillim negativ në këtë fushë në lidhje me lirinë e shprehjes ishte aprovimi i paketës ligjore kundër shpifjes, e cila u kritikua gjerësisht nga komuniteti i mediave dhe organizatat ndërkombëtare duke qenë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe shkelje të lirisë së shprehjes. Pas vetos së Presidentit për të hartuar ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 dhe Ligjin Nr. 9918/08, votimi për këto projektligje nga Parlamenti u shty deri në marrjen e opinionit të Komisionit të Venecias, i cili pritet të dalë në vitin 2020.

Referuar **qëndrueshmërisë dhe lehtësirave financiare**, kjo vazhdon të jetë një sfidë për OShC-të, ku shumë prej tyre varen nga fonde me bazë projektsh të mbështetura nga donatorët (kryesisht ndërkombëtarë). Mbështetja e shtetit, si financiare dhe jo-financiare, mbetet e dobët, sporadike dhe e

shpërndarë në mënyrë të ngushtë dhe jo transparente.

Në vitet e fundit ka një tendencë në rritje të krijimit të sipërmarrjeve sociale nga OSHC-të, si mjet për të siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të aktiviteteve të tyre, që gjithashtu mbështetet edhe nga strategjitë e donatorëve. Këto zhvillime nuk mbështeten nga një kuadër ligjor mundësues për krijimin dhe veprimtarinë e sipërmarrjeve sociale. Ligji për Ndërmarrjet Sociale i aprovuar në vitin 2016 dhe aktet nënligjore të tij paraqesin barriera reale për një funksionin normal të sipërmarrjeve sociale, si: mungesa e një përkufizimi të qartë e konceptit "ndërmarrje sociale" në ligj, përcaktimi i një set kriteresh ekonomik dhe socialë që shoqërohen me paqartësi dhe nivele gjobash, marrja në konsideratë e ndërmarrjeve sociale si subjekte të varura nga fondet publike, mos marrja në konsideratë të formave të tjera të mbështetjes nga pushteti vendor dhe prokurimi publik, dhe kushti i përdorimit të fitimit tërësisht për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të ndërmarrjes sociale. Edhe pse përfshihet si fushë veprimi në Udhërrëfyes, kuadri ligjor i aktivitetit filantropik ende nuk është rregulluar dhe nuk përdoret si një mundësi si nga OSHC-të ashtu edhe nga individët apo korporatat që dhurojnë.

Referuar trajtimit dhe përfitimeve financiare për OSHC-të, zhvillimi kryesor në vitin 2019 është miratimi i udhëzimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për rimbursimin e TVSH-së për fondet e donatorëve të huaj të OSHC-vë, si pjesë e të gjitha marrëveshjeve bilaterale dhe shumëpalëshe të ratifikuara nga Parlamenti shqiptar ose marrëveshjeve për fonde të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Udhëzimi u përgatit në bazë të kërkesave dhe sugjerimeve të OSHC-ve të paraqitura përmes një iniciative të suksesshme advokuese të udhëhequr nga Partnerët Shqipëri. Zbatimi i tij do të vlerësohet në vitet në vijim.

Referuar ***bashkëpunimit Shtet - OSHC***, gjatë vitit 2019 u miratua Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023. Një numër i ulët OSHC-sh morën pjesë në procesin e konsultimit për shkak të mungesës së informacionit mbi këtë proces, mungesës së besimit që opinionet e tyre do të merren në konsideratë, apo mungesës së interesit për të marrë pjesë duke marrë në konsideratë dështimin në zbatim të dokumentit të parë politik (Udhërrëfyesi 2015-2018), ku në përfundim të periudhës së zbatimit të tij asnjë raport vlerësimi nuk u përgatit dhe publikua.

Dokumenti i ri është përmirësuar duke përfshirë tregues konkret vlerësimi dhe një buxhet të parashikuar për zbatimin e masave të tij. Ai gjithashtu parashikon pjesëmarrjen e OSHC-ve në monitorimin e zbatimit të tij. Për të arritur këtë rekomandohet të hartohet një proces monitorimi dhe të krijohen mekanizma që do të mundësonin një pjesëmarrje më të gjerë të OSHC-ve në monitorim.

Referuar mekanizmave të bashkëpunimit, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile nuk arriti të provojë veten si një organ efektiv këshillues. Edhe këtë vit, pati mungesë ndërveprimi midis anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill dhe zgjedhësve të tyre, munguan diskutimet apo veprime konkrete në adresimin e çështjeve problematike të sektorit dhe në influencimin e vendimeve të qeverisë drejt krijimit të një mjedisi mundësues për shoqërinë civile në vend. Një strukturë tjetër e rëndësishme këshillimore ku përfaqësohet shoqëria civile është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, ku procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe funksionimi i tij janë të panjohura për OSHC-të. Për më tepër, edhe në mesin e anëtarëve të tij, ka konfuzion dhe mungesë informacioni për këto çështje. OSHC-të pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, përmes pjesëmarrjes së tyre në organet drejtuese dhe tryezave të konsultimit që do të krijohen. Efektiviteti i këtyre strukturave, si dhe roli dhe kontributi i OSHC-ve mbetet për tu vlerësuar në të ardhmen kur këto struktura të funksionojnë.

Në përgjithësi, proceset e konsultimit duhet të përmirësohen dhe të organizohen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në ligj. Ato duhet të konsiderohen si një mjet për të përmirësuar dokumentet duke marrë në konsideratë kontributin e OSHC-ve dhe grupeve të tjera të interesit, dhe jo vetëm si një detyrim ligjor .

Shtojcat

1. Metodologjia e Matricës së Monitorimit

Modelimi dhe mbledhja e të dhënave

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile është një kornizë e detajuar teorike e bazuar në të drejtat dhe liritë themelore ndërkombëtare të njeriut si dhe praktikën më të mira rregullatore në nivelin e Bashkimit Evropian dhe në vendet evropiane. Matrica është e organizuar rreth tre fushave kryesore: Garancitë Themelore Juridike të Lirive; Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të; Marrëdhënia Shtet - OSHC, secila e ndarë në disa nën-fusha. Fushat janë përcaktuar nëpërmjet standardeve kryesore të cilat janë përpunuar më tej nëpërmjet indikatorëve ligjorë dhe praktikë.

Indikatorët ligjorë maten duke hulumtuar mungesën apo pasjen e rregullave, procedurave, shpenzimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në kuadrin rregullues ligjor (parësor dhe dytësor) dhe politikën e miratuara në vendet përkatëse. Për të siguruar standardizimin dhe krahasueshmërinë e procesit të mbledhjes së të dhënave në lidhje me **indikatorët e praktikës**, studiuesit në nivel vendi ndjekin një plan metodologjic në të cilin secili nga 80 treguesit detajohen më tej në lloje në të dhëna konkrete të detyrueshme apo shtesë (d.m.th. dimensionet e detajuara të një treguesi praktik) që do të raportohen nga vende të ndryshme. Llojet e të dhënave të domosdoshme mbulojnë aspektet kryesore dhe më të rëndësishme të një treguesi praktik siç përshkruhen në Paketën Shpjeguese të Matricës së Monitorimit. Ato udhëheqin raportimin e informacionit më të dëshirueshëm (optimal) pa të cilin nuk do të ishte e mundur të vlerësohej treguesi përkatës. Të dhënat shtesë të specifikuar për secilin tregues praktik raportohen nëse studiuesit në nivel vendi dëshirojnë të thellohen dhe të ilustronjë më tej indikatorin specifik të praktikës (p.sh. studim rasti⁷¹)

Strategjia e mbledhjes së të dhënave për treguesit praktikë është përshtatur që të përputhet me llojet e të dhënave të domosdoshme të përcaktuara në planin e metodologjisë. Për secilin tregues ka një udhëzim të qartë për strategjinë e mbledhjes së të dhënave (instrumentet dhe burimet) që duhet të përdoren nga studiuesit vendas. Instrumentet dhe burimet e specifikuar për mbledhjen e të dhënave ndjekin një hierarki të nënkuptueshme, në të cilën të dhënat faktike të disponueshme publikisht (p.sh. statistikat zyrtare) janë burimi më i rëndësishëm i të dhënave

⁷¹ Shih seksionin tjetër mbi shënimet specifike të vendit mbi metodologjinë

për vlerësimin e treguesve të praktikës, ndjekur nga të dhënat e vëzhgimit me organizatat e shoqërisë civile, e cila nga ana tjetër pasohet nga burime dytësore përkatëse (p.sh. nga raportet e OSHC-ve, Avokati i Popullit dhe media). Në fund të hierarkisë janë të dhënat e intervistës së thelluar me çështje të veçanta, e cila është e dhënë subjektive dhe përfshin grupe më të vogla të intervistuarve.

Të dhënat parësore faktike dhe të dhënat dytësore janë mbledhur përmes hulumtimit/rishikimit të literaturës. Pas strategjisë së mbledhjes së të dhënave, studiuesit vendas kanë përdorur tre instrumente kryesore të mbledhjes së të dhënave: kërkesa për informacion drejtuar institucioneve publike, pyetësin e vëzhgimit dhe udhëzimet mbi çështjet që do të kryhet intervista. Pyetjet në instrumentet e mbledhjes së të dhënave janë përshtatur që të përputhen me llojet e domosdoshme të të dhënave të secilit tregues praktik. Kërkesat për të drejtën e informimit janë përdorur nga studiuesit kur informacioni publik dhe statistikat mbi zhvillimin e shoqërisë civile (të dhënat kryesore faktike) nuk janë të gatshme dhe në dispozicion të publikut. Studiuesit mund të marrin informacion nga një grup pyetjesh të kërkesave për të drejtën e informimit të hartuar për të matur indikatorët në praktikë.

Pyetësi i vëzhgimit mbledh informacione mbi përvojat dhe perceptimet e organizatave të shoqërisë civile mbi aspektet kryesore të mjedisit mundësues për shoqërinë civile për vitin 2019. Pyetësi përfshin 48 pyetje që përputhen me informacionin e domosdoshëm të të dhënave mbi të drejtat dhe liritë themelore, qëndrueshmërinë organizative dhe financiare dhe bashkëpunimin e shoqërisë civile me shtetin. Pyetësi kryesisht përbëhet nga pyetje të mbyllura, dhe më pak pyetje të hapura të cilat kërkojnë që të intervistuarit të shtjellojnë përvojën e tyre. I njëjti pyetësor zbatohet në të gjitha vendet, dhe vetëm formulimi i disa pyetjeve/ çështjeve është përshtatur në kontekstin e vendit për të siguruar që pyetjet të kuptohen nga të intervistuarit. Pyetësi dërgohet në listat zyrtare të OSHC-ve, të hartuara dhe të përditësuara nga studiuesit vendas, bazuar në regjistrat e disponueshëm ose listat e tjera alternative të OSHC-ve aktive në vend (për më shumë informacion, shihni seksionin mbi shënimet specifike mbi metodologjinë). Të dhënat e mbledhura nga pyetjet janë konfidenciale dhe përdoren rreptësisht vetëm në formë anonime. Përgjigjet individuale nuk janë të lidhura me organizatat që iu përgjigjën vëzhgimit dhe raportohen vetëm në mënyrë të përmbledhur.

Udhëzimet mbi intervistat për çështje të veçanta përfshijnë pyetje që – në mënyrë të ngjashme me pyetësin e vëzhgimit - përputhen me të dhënat e domosdoshme që përdoren në të gjitha vendet. Përveç këtyre pyetjeve të rëndësishme, studiuesit formojnë pyetje shtesë që synojnë të pasqyrojnë zhvillimet kontekstuale të vendit. Katër udhëzimet për intervistat gjysmë të strukturuar për çështje të veçanta janë kryer me përfaqësues të shoqatave të gazetarëve dhe profesionistëve të medias; përfaqësues të organizatave të vullnetarëve; përfaqësuesit e institucionit ose mekanizmit për bashkëpunimin e OSHC-ve dhe me përfaqësuesit e grupeve jo-formale të shoqërisë civile (p.sh. iniciativat e qytetarëve, lëvizjet shoqërore dhe nismat në internet).

Analiza dhe interpretimi i të dhënave

Për të analizuar dhe interpretuar të dhënat, studiuesit vendas kanë përdorur një model të unifikuar të

mblledhjes së të dhënave i cili ofron përshkrimin e indikatorëve (përfshirë të dhënat e domosdoshme dhe të dhënat sekondare për indikatorët e praktikës) dhe përshkrimet e pesë kategorive që fillojnë nga plotësisht mundësues deri në një mjedis aspak mundësues sipas secilit tregues. Pesë përshkrimet e kategorisë janë specifikuar për secilin tregues ligjor dhe praktik në Paketën Shpjeguese të Matricës së Monitorimit, për tu mundësuar kërkuesve - bazuar në të dhënat e raportuara - të zgjedhin një kategori, i cila përmbledh më saktë gjendjen e mjedisit mundësues në lidhje me treguesin përkatës. Në një hap të parë, studiuesi ka raportuar llojet e kërkuesve të të dhënave të mblledhura përmes burimeve të ndryshme në kutinë e modeleve. Për shembull, ata kanë raportuar të dhëna faktike nga burimet parësore të plotësuara me statistika përshkruese ose tabela së bashku me të dhënat e pyetësorit. Në një hap të dytë, ata kanë zgjedhur një nga pesë përshkrimet e kategorive të specifikuar për treguesin përkatës i cili ilustron më mirë të dhënat e raportuara. Kategoritë mundësojnë krahasimin e unifikuar të gjetjeve në nivelin e treguesve në të gjitha raportet e vendit.


2. Shënime mbi metodologjinë dhe sfidat shtetërore

Që nga shpallja e ciklit monitorues të mjedisit të shoqërisë civile në vitin 2013, Partnerët Shqipëri ka pasur për qëllim një proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës gjatë përgatitjes së Raportit të Matricës së Monitorimit, duke e prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të madh përfaqësuesish të OSHC-ve në të gjithë vendin. Këtë vit, vëzhgimi për përgatitjen e Raportit të MM u krye në 14 qytete dhe u kontaktuan 250 OSHC nga data baza e Partnerëve Shqipëri, nga të cilat 152 OSHC u përfshinë në studim. Pyetësi u administrua përmes intervistave ballë për ballë, telefon dhe Skype-it me drejtorët ekzekutiv dhe menaxherët e niveleve të larta të OSHC-ve.

Pyetësi u pasua nga intervista të thelluara për të eksploruar çështje kontradiktore ose fusha ku ishte i nevojshëm më shumë informacion për qëllime analize. Duke marrë parasysh sfidën me disponueshmërinë e të dhënave zyrtare për sektorin (numrin e OSHC-ve, formën e regjistrimit, shpërndarjen gjeografike, proporcionin sipas fushës së tyre të veprimtarive, etj.) dhe bazuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për numrin e OSHC-ve të regjistruara pranë këtyre autoriteteve gjatë vitit 2019. Kërkesa zyrtare iu dërguan gjithashtu të gjitha ministrive për shumën e fondeve publike të shpërndara për OSHC-të gjatë vitit, dhe për Parlamentit të Shqipërisë mbi konsultimin e projektligjeve me OSHC-të gjatë vitit 2019.


Intervistat u kryen në 11 Qarqe. Përzgjedhja e kampionit u realizua bazuar në numrin e OSHC-ve të lokalizuar në secilin qytet, dhe në vullnetin e organizatave për të marrë pjesë në vëzhgim. Grafiku 1 paraqet shpërndarjen gjeografike të organizatave pjesëmarrëse në studim.

Grafiku 1: Shpërndarja gjeografike e OSHC-ve të intervistuar




Përsa i përket formës ligjore të regjistrimit, kampioni është i përbërë nga 53% shoqata, 36% qendra dhe 11% fondacione, me përqindjet respektive siç tregohet në Grafikon 2.

Grafiku 2: Forma e regjistrimit të OSHC-ve të intervistuar



Bazuar në pyetjet me disa alternativa, në Grafikon 3 më poshtë janë paraqitur fushat e punës dhe aktivitetet kryesore të OSHC-ve të intervistuar:

Grafiku 3: Fushat e aktiviteteve të OSHC-ve të intervistuar



3. Burime të përdorura/Bibliografia

"Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Lokale 30 Qershor 2019 Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve ODIHR", OSBE - OHDIR 2019 [Online]

<https://www.osce.org/odihr/elections/albania/429230?download=true>

"Zgjedhjet Lokale 2019 Deklarata e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, OSBE - OHDIR, Qershor 2009 [Online]

<https://www.osce.org/odihr/elections/albania/424433?download=true>

Hapja e negociatave të antarsimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, Rezoluta e Parlamentit Evropian [Online]

https://eeas.europa.eu/delegations/albania/69440/resolution-european-parliament_en

"Balkan Barometer 2019: Studim i Opinioneve Publike" Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, 2019 [Online] <https://www.rcc.int/pubs/89/balkan-barometer-2019-public-opinion-survey>

"Doing Business, Matja e lehtësisë së të bërit biznes 2020", Banka Botërore, 2019 [Online]

https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/pdf/db2020/Doing-Business-2020_rankings.pdf

"Vështrim mbi filantropinë, Buletini Tremujor" Partnerët Shqipëri 2019, [Online]

<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/October-December-2019.pdf>

FZ 28/2001, Ligji nr. 8789, datë 07/05/2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" [Online]

<http://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>

Ligji Nr. 75/2019 "Për Rininë", Fletore Zyrtare 171/2015 180/2019 [Online]

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/180/7d10ef94-7c6e-4988-8c5d-362df7023217;q=Ligji%20per%20rinine>

Direktiva Nr. 62, datë 17.09.2015 "Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe për aplikimin e detyrueshëm të tij", lëshuar nga Ministria e Financave, Fletore Zyrtare 171/2015 [Online]

https://qbz.gov.al/share/msVHnvi8QI-INGH_26ccqQ

Ligji Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Fletore Zyrtare 79/2018

[Online] https://qbz.gov.al/share/msVHnvi8QI-INGH_26ccqQ

Ligji Nr. 33/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, Fletore Zyrtare 99/2019 [Online]

<https://qbz.gov.al/share/sC4WmeBESCK2tXgkknal7w>

Udhëzimi Nr. 19, datë 9.7.2019 "Për mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse në funksion të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", Gazeta Zyrtare 102/2019 [Online]

<https://qbz.gov.al/share/sC4WmeBESCK2tXgkknal7w>

Ligji nr 8788, datë 07/05/2001, "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Kapitulli VII, Fletore Zyrtare 36/2013 [Online]

<https://qbz.gov.al/share/s0AXcHUmTAm53LiuWwbpQ>

Ligji Nr. 97/2018, datë 3.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë" Fletore Zyrtare 187/2019
<https://qbz.gov.al/share/dfCkGpG0QtaJ-P4xOxC3xQ>

"Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë Maj 2018- Maj 2019", Partnerët Shqipëri [Online]
<https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-Matrix-Country-Report-for-Albania-2018.pdf>

Ligji nr. 65/ 2016, datë 09/06/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale Në Republikën E Shqipërisë", FZ 118/2016 [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/09/65-2016>

Udhëzim nr. 607, datë 01.08.2018, "Mbi procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale"[Online] <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Udhezim-nr.607-dt-01.08.2018-PER-MARRJEN-E-STATUSIT-TE-NDERMARRJES-SOCIALE.docx>

Informacioni është marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme [Online]
<https://punetejashtme.gov.al/en/grant-contracts-aëarded-during-december-2018/>

Informacioni është marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme [Online]
<https://punetejashtme.gov.al/en/grant-contracts-aëarded-during-september-2019/>

FZ 23/2001, Ligji nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për Tubimet" [Online]
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf

Informacioni është marrë nga faqja në internet e OSBE-së [Online]
<https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/425462?download=true>

Informacioni është marrë nga Televizioni Kombëtar Shqiptar [Online] <http://rti.rtsh.al/2020/01/23/anti-defamation-package-to-be-reviewed-by-venice-commission-in-march/>

"Paketa e Zgjerimit të BE-së 2018 - Liria e Shprehjes - Shoqëria e Informacionit dhe Medias", Komisioni Evropian, 2018. [Online]
https://euwesternbalkansmediadays.eu/images/FREEDOM_of_EXPRESSION_INFO_SOCIETY_AND_MEDIA_2018.pdf

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (me Ligjin Nr. 48/2012 (Fletore Zyrtare 53/2012) dhe me Ligjin Nr. 120/2014 (Fletore Zyrtare 160/2014) , [Online]
https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/fletepalosje_ligji_per_mbrojtjen_e_te_dhenave_personale.pdf

"Hoë Albanians Use the Internet Today?", Invest in Albania [Online]
<https://invest-in-albania.org/how-albanians-use-the-internet-today/>

"Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri", Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim 2019, [Online] <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2019/12/Need-Assessment-Report-2019.pdf>

Udhëzimi Nr. 34, datë 02.12.2019 "Për një Ndryshim të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015" Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, Fletore Zyrtare 169/2019
http://partnersalbania.org/ep-content/uploads/2016/02/Udhezim_34_5.12.2019_per_TVSH_FZ-2019-

[169.pdf](#)

Vendim nr. 953, datë 29.12.2014 "Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar Në Republikën E Shqipërisë", I Ndryshuar. [Online] <https://www.tatime.gov.al/eng/shkarko.php?id=707>

Ligji nr. 65/ 2016, datë 09/06/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale Në Republikën E Shqipërisë", FZ 118/2016 [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/09/65-2016>

Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponzorimet", i ndryshuar, Fletore Zyrtare 130/2007 [Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2007/09/20/9807/d3730c57-27d0-4a54-85d2-ead691eb9f45;q=Ligj%20per%20sponzorizimet>

Informacioni është marrë nga faqja e internetit e Agjencisë Telegrafike Shqiptare [Online] <https://ata.gov.al/2019/10/03/video-rama-me-biznesin-e-madh-fondi-i-shqiperise-solidare-nje-ide-te-ciles-i-ka-ardhur-koha/>

Ligji 39/2019 "Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara" [Online] <http://parlament.al/Files/Akte/20190624141111ligj%20nr.%2034,%20dt.%2017.6.2019.pdf>

"Rregullore e brendshme mbi procedurat e financimit me grant", AMSHC, Dhjetor 2016 [Online] <http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

Ligj nr.10 093, datë 9.3.2009 Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë për, Mbështetjen e Shoqërisë Civile [Online] http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/LIGJ_Nr._10093_date_9.3.2009.pdf

Rregullore mbi Procedurat E Financimit Me Grant Në Mbështetje Të Shoqërisë Civile [Online] <http://www.amshc.gov.al/web/doc/Vendim-per-Miratimin-e-Rregullores-Mbi-Procedurat-e-Financimit-Me-Grante.pdf>

Ligji 15/2019, datë 13.03.2019 "Për Nxitjen e Punësimit" [Online] <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190318131036ligj%20nr.%2015,%20dt.%2013.3.2019.pdf>

VKM Nr. 506, datë 17.07.2019 " Për Miratimin E Kodit Të Etikës Së Vullnetarit", Fletore Zyrtare [Online] 105/2019 <https://qbz.gov.al/share/7z7QPMOjSqagyGJfH8AWw>

Ligji 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", [Online] <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj-nr-15-dt-16-2-2017.pdf>

Panoramë e Eko-Sistemit të Sipërmarrjeve Sociale në Shqipëri ", Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2019 [Online] <http://partnersalbania.org/ëp-content/uploads/2019/04/Overview-of-Social-Enterprises-Eco-system-in-Albania.pdf>

FZ 200/2015, Ligji nr.119/2015 "Për Krijimin Dhe Funksonimin E Këshillit Kombëtar Për Shoqërinë Civile" [Online] <https://qbz.gov.al/share/q9X3GXAjROI2QTN3otTFAA>

Ligji nr. 15/2015 "Për Rolin E Kuvendit Në Procesin E Integritit Të Republikës Së Shqipërisë Në Bashkimin Europian" [online] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf

"Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian", Këshilli Kombëtar i Integritimit 2020 [Online] <http://parlament.al/Files/Integrimi/Raporti%20vjetor%20i%20KKE%202019.pdf>

Vendimi nr. 61/2018, datë 05.04.2018 "Për Miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", krijohet një regjistër lobist <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf>

Informacioni është marrë nga Kuvendi i Shqipërisë[Online]

<https://www.parlament.al/Files/Informacione/lobistet.xlsx>

1^a Raporti Vjetor 2019" Komisioneri për të Drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019

[Online] https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/03/Annual_Report_2019.pdf

"Pushteti vendor nën lanten e së drejtës për informim", BIRN 2019 [Online] <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2019/05/Pushteti-vendor-single-page-web-1.pdf>

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 246 datë 9.05.2018 "Për Miratimin e Planit Kombëtar Për Integritimin Evropian (NPEI) 2018 - 2020" [Online] <https://punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/vkm-nr-246-date-9-5-2018-2-plani-kombetar-per-integritimin-evropian-2018-2020.pdf>

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 111, datë 23.02.2018 "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Fondit Social", Fletore Zyrtare 27/2018 [Online]

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/27/adbe8f12-3962-4c64-a24d-2385c14d917f>

Lidhje të dobishme

Kuvendi i Shqipërisë

www.parlament.al

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

www.amshc.gov.al

Ministria e Kulturës

www.kultura.gov.al

Faqja zyrtare e internetit e Lotarisë Kombëtare

<http://lotaria.al>

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

<http://www.al.undp.org>

Regjistri Elektronik i Konsultimeve Publike

<https://konsultimipublik.gov.al>

